

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7789 E diel 10 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Rallëherë Shqipëria e ka pasur Rkçaq shumë propagandën media-tike në funksion të aksionit opozitar. Janë disa kanale televizive dhe media elektronike ...
Vijon në faqen 21

Nga BEN ANDONI
A po e lodh opozita me protestat, qeverisjen Rama?!



Opinion *i* **Ditës**
Nuk janë edhe aq të shumtë bijtë e këtij populli, të cilëve vendi dhe kombi u detyrohen, përjetësisht. Për ato që ata bënë, në kushtet e vështira dhe të mos mundjes ...
Vijon në faqen 22

Nga PANO HALLKO
Doktor Jani Basho, Fator i këtij vendi...



“Bëjmë ‘lungogjol’ deri në Tushemisht”
Rama: Do fitojmë edhe Pogradecin. Basha: I japim fund grushtit të shtetit

Opozita përgatitet për protestën e 16 shkurtit, kreu i PD: Shembim kalbësisrën
Zgjedhjet e 30 qershorit kryeministri Edi Rama i shëh jo vetëm si datën e rikonfirmimit të bashkive ku socialistët drejtuan këtë 4-vjeçar, por dhe atë të fitores së njësisë të tjera lokale që drejtohen nga opozita. Një nga këto z.Rama shprehet se do të jetë dhe Pogradeci ku dje mori pjesë për prezantimin e disa projekteve për rehabilitimin e disa zonave ...
Në faqet 3-4

KREU I ALUIZNI-T: QEVERIA, AKSION PER REGJISTRIMIN E TOKES BUJQESORE TOKE ME LIGJIN 7501, ARTAN LAME: SI DO NDAHEN TAPITE

Aktet e marrjes së pronës në përdorim do të shndërrohen në certifikata pronësie. Përfundon procesi i legalizimeve në Pezë. Ç’thotë ligji, ja kush përfiton



(Në foto) Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame dhe në Pezë

“PSE MBAJTA QENDRIM”
Meta për “Zërin e Amerikës”: Unaza, dëshmi e sundimit të shumicës, jo të ligjit
Në faqen 2

DHUNA
Skandali në Kavajë, prokuroria nis hetimet për stafin e shkollës
Në faqen 9

SHKRIMTARI I NJOHUR
Përcillet Kiço Blushi, Rexhep Qosja: Ja fjalët e ndershme që ia pas
Në faqen 12

DEPUTETI I PS
Ahmetaj: U konfirmua rënia e borxhit publik, rritje ekonomike mbi 4%
Në faqen 6

“MILOSAO”

Rasti i rrallë i Rami Saarit, hebreu që përktheu letërsinë shqipe
Suplement

Kujdesi për moshën e tretë, Mira Pirdeni: Problem, varfëria dhe pensionet
“Luarasi”, konferencë ndërkombëtare për të moshuarit
Ethem Ruka: T’i ofrojmë një jetë sa më dinjitoze kësaj kategorie

NGA VOLTIZA DURO
Sipas raportit të OKB-së, Shqipëria renditet në grupin e dhjetë vendeve që ka pësuar plakjen më të shpejtë të popullsisë. Mbi 650 mijë të moshuar në vendin tonë përveç pensioneve të ulëta, përjetojnë edhe diskriminim



im moshor aktiv. Në kuadër të sensibilizimit dhe ofrimit të zgjidhjeve, universiteti ‘Luarasi’ në bashkëpunim me Shoqërinë Shqiptare për të Gjitha Moshat (ASAG), organizuan konferencën ndërkombëtare me temë “Shëndeti, drejtësia sociale dhe ekonomike ...
Në faqen 11

PRESIDENTI INTERVISTA

Rama e quajti drejtuesin më serioz të opozitës, presidenti: Qëndrimi im sipas ligjit

"Cakaj", Meta: E kam të qartë, Edi Rama ministër i Jashtëm

"Unaza, i detyruar të mbaj një qëndrim"

Presidenti Ilir Meta iu përgjigj dje nga SHBA-deklarata të kryeministrit Rama, i cili e etiketoi si drejtuesin më serioz të opozitës, pas refuzimit të Gent Cakaj në krye të Ministrisë së Jashtëm. Në një intervistë për VOA, Meta tha se qëndrimi i tij ka qenë i përputhur me Kushtetutën dhe detyrimet kushtetuese të presidentit. Mohimin e vizave për mbi 170 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve publikë nga ambasada amerikane, presidenti Meta e quajti një përkëqesim të drejtësisë shqiptare, teksa kërkoi ndihmën e SHBA dhe BE për ngritjen e institucioneve të drejtësisë.

Zoti President! Gjatë ditëve që kemi qenë në Uashington, në takimet që kemi patur, ju jeni shprehur edhe për çështjen e dialogut të Kosovës me Serbinë. Beogradit dhe Prishtinës iu është kërkuar që të jenë krijuar në arritjen e një marrëveshjeje, gjë që është përkthyer edhe në mundësinë e shkëmbimit të territoreve, korrigjimit të kufirit, ndryshimit të kufijve; një temë që ka qenë tabu më parë. Ju jeni shprehur se nuk duhet të ketë ndryshim kufijsh. Përse kjo kundërshti, kur nuk dihet ende se për çfarë po diskutohet?

Unë pajtohem plotësisht me ju që është i domosdoshëm, madje është i vonuar, do të thosha, gjithë ai proces që ka të bëjë me përfundimin e dialogut Kosovë-Serbi, pasi ky është një dialog që po vazhdon prej mjaft vitesh. Është një dialog që u quajt "për normalizimin" dhe tani të gjithë kërkojnë finalizimin e tij, ndërkohë që ne ende nuk kemi një bilanc të plotë të normalizimit dhe të zbatimit të marrëveshjeve të deritanishme. Megjithatë, përsëri unë bashkohem me atë kërkesë, me atë interes të përgjithshëm, sepse është interes edhe i Shqipërisë, po është interes edhe i partnerëve tanë dhe i vet proceseve integruese, të cilave ne iu jemi bashkuar dhe që kërkojmë të fitojnë shtytë të re për realizimin të kësaj marrëveshjeje, që kjo gjë të realizohet sa më parë. Por i dimë vështirësitë e deritanishme, të cilat shpeshojmë të kapërcehen me reflektim të përbashkët nga të dyja palët, për të krijuar atë mirëbesim, që ka munguar deri tani.

Të ndalem të problemet, të zhvillimet në Shqipëri. Ju patët një përplasje të fortë me qeverinë për çështjen e ministrit të Jashtëm si dhe pas publikimit të qëndrimit tuaj për çështjen e Unazës së Madhe, ku ju kërkuat të anulohen gjithë kontratat dhe projektet të ribëhet nga e para. Shumica ju akuzoi se ju po mbani pozicione politike, që bien ndesh me detyrën tuaj si president i vendit. Madje kryeministri Rama iu cilësoi si drejtuesin më serioz të opozitës. Si iu përgjigjeni ju këtyre kritikave?

Në detyrën time si presi-



Presidenti Ilir Meta, një intervistë për VOA

dent unë i referohem vetëm Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, interesit kombëtar dhe interesit publik. Në çështjen e ministrit të Jashtëm nuk besoj se kërkon shumë energji për t'u përgjigjur si gjitha kundërshtimeve në lidhje me qëndrimin tim, për arsye se kam qenë mjaft i hapur për çdo zgjidhje për personin e propozuar nga kryeministri. Por nuk besoj se dikush mund të fajtojë Presidentin, kompetencat e të cilit në fushën e politikës së jashtme janë përcaktuar shumë qartë edhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i kërkuar nga vet Partia Socialiste dikur në opozitë për çështjen e marrëveshjes së detit, pra që Presidentin iu kërkuar të konfirmojë në këtë detyrë një person, cilatdo qofshin cilësitë e tij të shkëlqyer, të cilin nuk e ka takuar asnjëherë, të cilin nuk e njeh dhe i cili do të firmosë marrëveshje në emër të Republikës së Shqipërisë, të cilat mund të prodhojnë pasoja afatgjata dhe të paparashikueshme. Qëndrimi ka qenë tepër konstruktiv dhe ka qenë një qëndrim, i cili ka patur në konsideratë Kushtetutën dhe detyrimet kushtetuese të presidentit, edhe interesin kombëtar edhe interesin publik. Për më tepër personi kishte bërë deklarata në një televizion të Kosovës, të cilat nuk kishin asnjë lidhje me qëndrimet shprehore të Shqipërisë në fushën e politikës së jashtme. Ndërsa për sa i takon Unazën së re, në mos gaboj, sot bëhen 100 ditë nga fillimi i protestave dhe unë si President, pa patur asnjë parargjykim për shkak të problemit publik dhe protestave të vazhdueshme të transmetuara nga të gjithë

mediat, dhe të kërkesave të qytetarëve, kam ushtruar përgjegjësitë e mia, kam kërkuar informacione në mënyrë të vazhduar, në mënyrë të përsëritur. Bazuar në ligjet e shtetit për informim ndaj çdo qytetari dhe zyrtari, po duke u bazuar edhe në Kushtetutën e vendit, institucionet janë të detyruar të japin informacione dhe përgjigje presidentit për çdo kërkesë dhe për çdo shqetësim, e në fund fare kam qenë i detyruar të mbaj një qëndrim, pasi kam krijuar një bindje, për të cilën jam shprehur publikisht dhe të cilës vazhdoj t'i qëndroj me bindje të plotë: Shpikje të tilla jashtë legjislacionit që vendi ynë ka, jashtë rendit tonë juridik

zbatimin e ligjit në vend për të ardhmen.

Tani që ministri i Jashtëm u ndryshua dhe erdhi ministri i ri, i cili u ngarkua nga kryeministri për të kryer funksionin e ministrit të Jashtëm, më lejoni t'iu pyes: A do të ketë kjo ndikim lidhur me negociatat me Greqinë? A mund ta sqaroni këtë? A i ka ministri i ri i ngarkuar kompetencat e plota, që i ka patur i mëparshmi?

Do të doja të bëja një korrigjim. Duke iu referuar asaj çfarë ka shprehur ish-kandidati për ministër të jashtëm: nuk kishte të bënte me çështjen e negociatave me Greqinë, por kishte të bënte me një qëndrim të shprehur prej

thelbin e pyetjes tuaj, se nuk doja të lija një keqkuptim: Presidenti e ka shumë të qartë dhe autorizon vetëm ministrin e jashtëm, i cili në këtë rast është vet kryeministri, me kërkesën e tij, dhe ai quhet zoti Edi Rama.

Ai transferoi kompetencat të zoti Cakaj.

Unë e kam shumë të qartë se cila është detyra ime dhe cili është detyrimi im kushtetues.

Jemi ende të bisedimet me Greqinë. Ndërsa u duk se palët ishin shumë afër arritjes së një marrëveshje ose përfundimit të negociatave, duket se çështjet kanë mbetur pezull, janë lënë në harresë. A mendoni se ka ende shpresë, se mund të arrihet një marrëveshje së shpejti, ose ku është statusi i kësaj marrëveshjeje?

Besoj se unë i kam përbushur dhe vazhdoj t'i përbush me përgjegjësi të gjitha detyrimet e mia kushtetuese si President i Republikës dhe për këtë një ndihmë të madhe kam nga vetë vendimi i Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje dhe për çdo marrëveshje të ngjashme të këtij karakteri dhe do të vazhdoj në këtë mënyrë deri në fund. Jam shumë i interesuar që kjo çështje të ishte zgjidhur që dje, pra, dhe jo sot apo nesër. Gjithmonë referuar Kushtetutës dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Re-



Kryeministri Edi Rama, dje në Korçë

lidhur me këtë kërkesë?

Nuk kam patur mundësi të marr ndonjë vendim, për arsye se edhe nuk kam qenë në zyrë gjatë kësaj kohe, por megjithatë ekipi im po punon, por njëkohësisht na duhet të kemi një vlerësim më të plotë dhe më shterues për rastin në fjalë, pasi kemi edhe pretendimet nga ana e komandantit të Forcave Detare, i cili pretendon që ka parajamëruar për pasojat apo rreziqet e një fenomeni të tillë, ka kërkuar të merren disa masa. Ne kemi kërkuar të shohim edhe vlerësimin e ministrit, të inspektimit që është bërë dhe do të marrim vendim më të drejtë dhe do ta bëjmë publik në mënyrën më transparente.

Këto ditë ambasada amerikane në Tiranë bëri të ditur se ajo u ka mohuar dhe revokuar vizat mbi 170 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve publikë që nga viti 2017. A mendoni se ky është një tregues i faktit se korrupsioni në Shqipëri është shtrirë në nivele të larta dhe lufta ndaj tij mbetet ende shumë e dobët?

Për këtë nuk mjafton vetëm ky rast apo ky fakt që shprehur ju. Për fat të keq, raportet e Transparency International tregojnë një përkëqesim. Unë mendoj që është shumë e rëndësishme që SHBA dhe BE të vijojnë në mënyrë më aktive angazhimin e tyre për të ndihmuar në ngritjen e besueshmë të institucioneve të reja të reformës në drejtësi, të japin një mbështetje dhe inkurajim më të madh për ONM-në, të cilën ne e vendosëm edhe në Kushtetutë, dhe për vlerësimet e saj, në mënyrë që ne t'i kemi sa më shpejt këto institucione në punë, t'i kemi sa më të besueshme dhe sa më të paanshme.

Në një përplasje që pati me ministrin e Drejtësisë, pasi ministria e Drejtësisë arrestoi dhe po ndiqen penalisht disa persona që kanë qenë zyrtarë të LSI-së më parë për disa shkelje në këtë ministri, kryetarja e LSI-së

PËRPLASJA

"Presidenti e ka shumë të qartë të qartë dhe autorizon vetëm ministrin e Jashtëm, i cili në këtë rast është vet kryeministri, me kërkesën e tij, dhe ai quhet zoti Edi Rama. Unë e kam shumë të qartë se cila është detyra ime dhe cili është detyrimi im kushtetues", tha z.Meta.

dhe kushtetues nuk tregojnë për një vend, ku sundon ligji, por tregojnë thjesht për një vend ku sundon shumica. Ky është një koncept që nuk ka lidhje me shtetin e së drejtës, për më tepër që jemi në qendër të vëmendjes për sa i takon respektimit të ligjit, për sa i takon rregullave të opinionit publik, për sa i takon çështjeve të konkurrencës dhe nga partnerët ndërkombëtarë. Reflektimi ndaj kësaj çështje mendoi se është në interes të publikut, është në interes të vet qeverisë dhe të përmirësimit të perceptimit për seriozitetin që kemi në

tij në lidhje me një koncept të ri, që ka dalë për korrigjime të përgjithshme territoriale në Ballkanin Perëndimor, sepse nuk ka lidhje me këtë çështje. Ndërsa çështjen e marrëdhënieve me Greqinë e lidha thjesht me vendimin që është në fuqi të Gjykatës Kushtetuese për shkak të marrëveshjes së mëparshme, që u rrezua pas kërkesës së Partisë Socialiste, i cili përcaktonte se cilat janë kompetencat e Presidentit dhe të (d) institucioni në fushën e politikës së jashtme për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Për të ardhur në

publikës së Shqipërisë, në mënyrë që të hidhet një hap tjetër përpara edhe në marrëdhëniet tona me fqinjin jugor.

Muajin e kaluar në bazën e Pashallimit ndodhi një vjedhje e një sasie municionit. Ministria e Mbrojtjes mori një seri masash pak ditë më parë. U shkarkuan 15 zyrtarë ushtarakë, ndërkohë që javën e kaluar ministria e Mbrojtjes iu ka dërguar ju një propozim për shkarkimin e komandantit të Flotës Detare, gjeneralin Ylber Dogani. A kemi marrë ndonjë vendim deri tani



Kryeministri prezanton kolonjarin që ndërtoi jaht: Një Lul për së mbari

Edi Rama: Gati projektet, do të fitojmë Pogradecin

"Lungo gjol" nga Pogradeci në Tushemisht"

Zgjedhjet e 30 qershorit kryeministri Edi Rama i sheh jo vetëm si datën e rikonfirmimit të bashkive ku socialistët drejtuan këtë 4-vjeçar, por dhe atë të fitores së njëjësive të tjera lokale që drejtohen nga opozita. Një nga këto z.Rama shprehet se do të jetë dhe Pogradeci ku dje mori pjesë për prezantimin e disa projekteve për rehabilitimin e disa zonave rurale në këtë qark të listuar në programin e 100 fshatrave. "Ju themi qytetarëve të Pogradecit që pavarësisht se nuk e kemi drejtimin e kësaj bashkie, vëmendjen e kemi maksimale. Në fundin e qershorit kjo vëmendje do të shtohet pasi të marrim drejtimin", deklaroi z.Rama. Kryeministri Edi Rama gjatë vizitës në qarkun e Korçës dje u ndal edhe në Tushemisht të Pogradecit, fshat që është pjesë e projektit të "100 fshatrave turistike" në Shqipëri. Ai tha se, ky fshat është me potencial fantastik, por ende i pashfrytëzuar, ndërsa shumë shpejt do të nisë zbatimin e projekteve. "Do të kemi një 'lungo gjol' nga hyrja e Pogradecit deri këtu. Një segment i posaçëm i shkëputur i kësaj linje do të ndërtohet në Lin. Punën ta avancojmë në çdo aspekt të programit, modelat dhe pikat e referimit që do të krijojnë gravitet të ndryshme, të një rilindje rurale të shtrirë në të gjitha komponentët e zhvillimit. Jam shpresë plotë që do të rikthehem jo më për të prezantuar projektet, por për të nisur realizimin konkret të tyre. Ky nuk është një program i zakonshëm, së dyti nuk është program ndërtimi rrugësh rurale. I siguroj të gjitha ata që na ndjekin që janë qytetarë të kësaj zone, se përndryshe nga sa mund të duket, se ne nuk kemi drejtimin e bashkisë së Pogradecit, kemi qenë dhe jemi shumë të vëmendshëm që jo vetëm kjo zonë e bekuar të mos mbetet mbrrapa, por përkundrazi, rruga hyrëse në Pogradec është shprehja e këtij angazhimi. Të gjitha këto projekte presin fundin e qershorit për të marrë atë fuqinë e domosdoshme ekzekutive të një sinergjie të re me qeverisë me pushtetin vendor", theksoi z. Rama. Aktualisht bashkia e Pogradecit drejtohet nga Eduard Kapri, i zgjedhur nga radhët e PD-së para katër viteve, ndërsa në 30 qershor Partia Socialiste synon që të



Kryeministri Edi Rama

PROTESTA

Vizita e Kryeministrit Edi Rama në Korçë dje u shoqërua me protestë. Qytetarët atje e pritën me protesta dhe thirrje kundër qeverisë. Qytetarët që i janë përgjigjur thirrjes së opozitës, marshuan në rrugët e qytetit, duke hedhur parulla kundër qeverisë dhe bashkisë së Korçës.

PREZANTIMI
Kryeministri prezantoi një profesionist nga Kolonja, i cili ka ndërtuar me duart e tij një jaht, i cili sipas kreut të qeverisë është gati për të dalë në det. Rama bën ironi edhe me kreun e PD, Basha, pasi mban të njëjtin emër me profesionistin. "E rrallë - Një jaht në majë të malit në Kolonjë, ku Lul (një Lul për së mbari) ndërton ëndrrat e tij me fuqinë e një pasioni të jashtëzakonshëm #RESPEKT" - shprehet z.Rama.

goditi ministrën e Drejtësisë dhe i mori në mbrojtje këta njerëz. Madje nxori edhe emrin tuaj; deri tani, tha, nuk e kam nxjerrë emrin e ministres së Drejtësisë, pasi ajo ka lidhje familjare me ju. A janë këto sinjale të qarta që politikanët duhet të nxjerrin, ndërkohë që vendi ka një problem serioz me korrupsionin?

Problemi padyshim që është më i rëndësishëm përderisa, e theksoj edhe një herë, Transparency International e nxjerr të përqesuesar dje vitet e fundit vlerësimin për Shqipërinë. Duhet të ndodhte e kundërta. Në kuadër të reformës në drejtësi duhet të kishte një frenim, duhet të kishte një kujdes më të madh në respektimin e ligjit dhe të Kushtetutës, duhet të kishte një reagim më të shpejtë ndaj rasteve të qarta dhe ndaj rasteve publike. Unë përsërisht çdo procedim, që bëhet ndaj kujtdo, qofshin edhe raste të tilla si ajo që ka ndodhur në Ministrinë e Drejtësisë ditët e fundit sipas këtij varianti që ju po shprehni. Megjithatë ka disa çështje që janë shumë madhore, sepse çështje të tilla padyshim që ka dhe do të ketë. Sepse çdo ditë ka prokurime dhe mund të ketë edhe shkelje edhe korrupsion. Por ka disa raste ku është e rëndësishme të përqendrohem më shumë për të vendosur vlerën besimit në funksionimin e shtetit, në sundimin e ligjit. Më konkretisht, unë do të theksoja faktin skandaloz të shkeljes së Kushtetutës lidhur me dhënien fuqi prapavepruese për shpërndarjen e dividendit për të kaluarën, i cili sjell implikime të mëdha dhe mund të sjellë edhe pasojat të mëdha në të ardhmen në dëm të interesit publik dhe në dëm të funksionimit normal të rendit juridik dhe kushtetues në një shtet të së drejtës. Apo edhe rasti tjetër i Unazës së Re është një rast flagrant, ku kemi një shkelje të hapur të të drejtave të njeriut, përveç fenomenit jo transparent. Nga ana ime prokuroria dhe çdo agjenci ligjzbatuese ka patur, ka dhe do të ketë mbështetjen më të plotë, por edhe duhet të tregojë bindshëm se është jashtë çdo ndikimi politik edhe partiak.

Rikandidimi i Dakos?, Balla: Kryebashkiakët në proces vlerësimi

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla në emisionin "Kjo Javë" në News24 foli dje për zgjedhjet lokale të qershorit si dhe kandidatët e PS. I pyetur nëse do të rikonfirmohet kandidatura e Vangjush Dakos në krye të bashkisë së Durrësit pas akuzave të opozitës për lidhje me Avdyllajt dhe blerje votash, Balla tha se po bëhet vlerësimi për gjithë kryebashkiakët e PS dhe punën e tyre. Balla u shpreh se edhe nëse nuk konfirmohet Dako, ai do japë kontributin e tij për Durrësin dhe PS. "Ne kemi nisur një proces vlerësimi të kryetarëve në 35 bashki ku PS qeveris prej prillit të vitit të kaluar. Nga gjithë ky proces analize jemi në një fazë ku kemi vlerësuar se cilët janë ata që mund të marrin një mandat tjetër. Unë ndaj mendimin se Sotirag Filo në Korçë ka bërë një punë të mirë. Dako është prej vitit 2007 në krye të bashkisë së Durrësit dhe ky qytet ka njohur një transformim të thellë, por në momentin e duhur do të jetë vetë Dako dhe struktura e PS Durrës dhe PS që do vendosë. Edhe nëse nuk do ishte në krye të bashkisë, kjo nuk e pengon që ai të vazhdojë aktivitetin e tij në mbështetje të zhvillimit të Durrësit. Sa i përket bashkisë së Elbasanit, është e sigurt që do vazhdojë të drejtojë PS"- theksoi z.Balla.

Akuza, Kryemadhi: Miqtë e Ramës vodhën 4,4 mln euro për 4 orë

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi bëri thirrje për t'u bashkuar protestës së 16 shkurtit. Në takimin me strukturat socialiste në Korçë, paraditen e sotme, Kryemadhi tha se protesta nuk do të jetë vetëm e opozitës, por dhe e socialistëve të ndërshtëm që janë të pakënaqur nga qeveria Rama. E ndodhur në Korçë, aty ku shumë qytetarë protestuan kundër qeverisë, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi takoi nga afër edhe përfaqësuesit e forcës politike që përfaqëson. Nga ky qytet, ajo nuk nguroi të ironizojë kryeministrin e vendit Edi Rama. "Dëgjoja dje se si ulërinte këtu nga Korça dhe thoshën se çdo të enjte do shkojmë të flemë me qentë



dhe do marrim pleshta në parlament. Fliste për parlament ku bleu vota për të krijuar qeverinë e genve", tha ajo. Kryemadhi foli edhe për një episod, që e quajti skandal përmes të cilit tha se shqiptarëve u janë vjedhur për 4 orë 4,4 mln euro. "Pak ditë më parë ka ndodhur një vjedhje spektakolare. Pa e sqaruar këtu nga Korça. Ju e

dini që kemi një ndërmarrje që quhet KESH që detyrohet t'ia shesë OST energjinë dhe OST ia transmeton OSHEE. Qeveria jonë me ato individë, miqtë Ramës ia blenë KESH me 39 euro megavatit dhe pas 4 orësh ia shitën OST me 49 euro megavatit. Pra, për katër orë iu kanë vjedhur 4,4 mln euro shqiptarëve, tha ajo.

rimarrë drejtimin e saj.

VIZITA

Kryeministri Rama vizitoi dhe maternitetin e ri të qytetit, një investim nga buxheti i shtetit me vlerë 1.5 milionë euro për infrastrukturën dhe 800 mijë euro për pajisjet. Gjatë bashkëbisedimit me mjekët, gjeti rastin t'u përgjigjet akuzave për abuzime me koncesionet e partneritetit privat publik. "Është një histori e pabesueshme. Ne kemi investuar dhe i kemi kërkuar ndihmë privatit që të garantojmë cilësinë më të lartë të instru-

menteve mjekësore që ju po e thoni vetë ishin që në kohën e dashurisë shqiptarokineze dhe faktikisht privati ka bërë investimin, ne paguajmë çdo vit. Garantohet një ulje drastike e infeksioneve post-operatore, që ju e dini më mirë se unë, garantohet që ju punoni në kushte optimale, me instrumente optimale dhe ne hamë dynjanë. Por, e rëndësishme është që ju jeni në rregull", u shpreh kryeministri Rama. Vizitoi disa nga nënat e reja që kishin sjellë fëmijët në jetë në maternite-

tin e ri dhe iu dha në dorë çekun e bebes shoqëruar me urimin për të shtuar familjet e tyre. Nuk munguan as batutat. "Edhe 100, edhe djali vjen me lekë me vetë" u shpreh Rama në momentin që i dha çekun njëres prej nënave. Gjatë vizitës në Korçë, kryeministri inspektoi markatën e re i shëndërruar në një treg modern, i cili është gati presë tregtarët dhe qytetarët e parë. Gjithashtu, Rama ka inspektuar edhe punimet për ndërtimin e terminalit të ri të autobusëve në hyrje të qytetit të Korçës.

PROTESTAT TAKIMET

Kreu i opozitës me studentët në Vlorë: 3 zgjidhjet e PD-së për arsimin

Basha: Fund grushtit të shtetit, do shembim sistemin e kalbur

"Me PD-në në pushtet shqiptarët paga dinjitoze"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha u kërkoi dje si mirditorëve dhe gjirokastritëve të vendosen në ballë të protestës së 16 shkurtit për t'i hapur rrugën krijimit të një qeverie teknike. Sipas Bashës, fjalët nuk bëjnë më punë pasi Edi Rama ka përqendruar në duart e tij të gjithë pushtetet, përfshirë dhe atë të drejtësisë. Pasoja për të u dëshmuar me vendimin e gjykatës për Dritan Dajtin. "E patë çfarë ndodhi, vrau 4 policë dhe e dënuan me 25 vjet", deklaroi z.Basha. Ai e cilësoi qeverisjen si 'grusht shteti' që duhet të rrëzohet në datë 16 shkurt. Edhe pse programin politik thotë se e ka gati dhe do ta prezantojë pasi të largojë Edi Ramën nga zyra kryeministore të shtunën e ardhshme, Basha renditi disa nga prioritetet mes të cilave hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritje të pagave e pensioneve. Marrëveshja e 17 majit me Edi Ramën vazhdon ta përndjekë Lulzim Bashën. Mosbesimin e tyre për ripërsëritje të një tjetër shtrëngimi duars me kryeministrin, demokratët që takon ia shprehin në çdo qytet. "Qeveria duhet të mësojë si të hapë vende pune, të garantojë sigurinë, punësimin, arsimin, kontrata me njerëzit për t'i shërbyer njerëzve jo për të vjedhur fondet publike, me skema korruptive, për të zhdukur fondet e shëndetësisë me koncesione. Objektivi numër 1 është hapja e vendeve të punës me paga e kushte dinjitoze për shqiptarët dhe të rinjtë", deklaroi z.Basha. Gjatë takimit me qytetarë të shumtë në Gjirokastrë, kreu i PD, Lulzim Basha deklaroi se pa shembur këtë sistem të kalbur vendi nuk ka të ardhme. Kryedemokrati i ftoi qytetarët e Gjirokastrës të marrin pjesë masivisht në protestën e 16 shkurtit në Tiranë, pasi sipas tij të bashkuar mund të hapet rruga për integrimin e vendit dhe çlirimin nga korrupsioni,



Kreu i Opozitës Lulzim Basha, dje në Gjirokastrë

AKUZA

"Kurrë s'na e ka marrë mendja se pas 28 vitesh do të vinim në një stad ku për t'u emëruar në arsim duhet të merren injorantë e njerëz me precedentë penalë veç se janë anëtarë të një sekti kriminal si "Rilindja". Kjo tani është kthyer në rregull, çka ka shkatërruar cilësinë e mësimdhënies dhe besimin e prindërve tek arsimi publik", - tha z.Basha.

"Rama të qëndrojë larg nga PDIU dhe nga Çamëria"

Idrizi: Vendit i duhen zgjedhje të parakohshme e qeveri tranzitore

Kreu i PDIU Shpëtim Idrizi mbledhi dje strukturat e Tiranës nga ku u bëri thirrje shqiptarëve që të bashkohen në protestën e opozitës në 16 shkurt. Sipas tij Shqipëria ka nevojë për zgjedhje politike përmes zgjedhjeve të parakohshme dhe qeverisë tranzitore. "Në Shqipëri duhet të kemi një zgjidhje politike që kalon nga zgjedhje të parakohshme, në një qeveri tranzitore, e cila do të bëjë të mundur që shqiptarët për herë të parë të zgjedhin. Kjo është arsyeja që unë ju ftoj të gjithëve, simpatizantë të PDIU-së dhe çdo shqiptar që të bashkohen në protestën e opozitës në 16 shkurt. E të gjithë bashkë të mundësojmë që Shqipëria t'i rikthehet normalitetit", deklaroi z.Idrizi. Ai lëshoi akuza të forta për PDIU gjatë zgjedhjeve të fundit, duke thënë se PDIU u rrit me 35% në zgjedhjet parlamentare të kaluara, por votat u vodhën nga maxhoranca. Më tej, ai thek-



FATMIR MEDIU

Kreu i PR-së, Fatmir Mediu mori pjesë në konferencën "Pengesat e Ballkanit për anëtarësimin në BE", e organizuar nga Transatlantic Leadership Network. Mediu renditi disa prej pengesave të Shqipërisë në rrugën drejt BE. Shkak sipas tij janë blerja e votës, mungesa e gjykatës Kushtetuese, mosfunksionimi i Gjykatës së Lartë, ikja e të rinjve, rezultatet e dobëta në luftën kundër krimit,

soi se PDIU është nga partitë e vetme në Shqipëri që e di pse ekziston dhe që ka një mision të qartë. "Ne kërkojmë atdheun tonë dhe nuk kërkojmë pronat. Ne sot kemi një rezolutë për shqiptarët e Çamërisë. Do luftojmë çdo ditë për dinjitetin njerëzor. Fqinji jonë vlon sot nga racizmi dhe nacionalizmi për shqiptarët. Shteti shqiptar ka detyrim t'i

adresohet NATO dhe të hapë atje çështjen çame, por nuk ka këllqe e dinjitet përballë Greqisë. Ne sot kemi një varrezë për shqiptarët e Çamërisë. Ligji për minoritetet është poshtërues për shqiptarët. Kemi qenë dhe jemi për bashkim kombëtar për të afruar shqiptarët e Shqipërisë me Kosovën"- theksoi z.Idrizi.

mbajtur vendin peng. Nuk i bëhet vonë që Gjirokastra braktiset çdo ditë. Ne duhet t'i japim fund këtij sistemi,

pasi ky sistem nuk ju mbron dhe nuk ju shërben. Ky është sistem që është ka asgjësuar mirëqenia e gjithë sh-



Bashkëbisedimi me studentët dhe pedagogët dje në universitetin e Vlorës

Shkodra, Korça e Gjirokastra në protestë: Qeveria na braktisi

Opozita organizoi dje të tjera protesta në të gjithë vendin. Dita e djeshme e gjeti Shkodrën, Korçën dhe Gjirokastrën në protestë, kundër qeverisë dhe Ramës. Protestuesit deklaruan se rritja e çmimeve, mungesa e punës e kanë bërë shumë më të vështirë jetesën në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. "Në 6 vjet qeverisje, Rama blloko çdo investim për veriun e sidomos për kryeqendrën historike, Shkodrën, - deklarojnë protestuesit. Kjo situatë, shoqëruar sipas tyre edhe me rritjen e frikshme të krimit e bandave kriminale, po i detyron të rinjtë të ikin në emigracion. "Dy rrugë ka për të rinjtë, ose të bëhen pjesë e bandave kriminale, ose të ikin në Gjermani", deklaruan qytetarët. Qytetarët e Korçës dhe zonave përreth, protestuan në qendër të qytetit dhe në sheshin përpara bashkisë, duke ngritur zërin për gjendjen e vështirë që po kalon aktualisht çdo qytetar.



qiptarëve. Ky është sistemi që pasuron vetëm një grup oligarkësh. Nuk ka rrugë tjetër që mund të na çojë drejt mirëqenies përveç rrugës evropiane, por ajo derë do qëndrojë e mbyllur përdërisa kjo qeveria nuk ka ardhur në pushtet me votën e qytetarëve, por me ndihmën e krimit. Pa përmbytur këtë sistem të kalbur vendi nuk ka të ardhme. Koha për fjalë ka mbaruar. Në datën 16 shkurt e jani flisni me pjesëmarrjen tuaj. Të bashkuar të hapim rrugën e bllokuar nga kjo klikë oligarkësh"- theksoi z.Basha. Në turin e takimeve për protestën e 16 shkurtit, lideri i PD, Lulzim Basha po dje zhvilloi një bashkëbisedim me studentët e pedagogët të universitetit "Ismael Qemali" në Vlorë. Duke i ftuar ata në protestë, Basha shpalloi edhe platformën e tij për arsimin. Sipas tij, sapo PD-ja të vijë në pushtet do të mar-

rë fund pjesa e militantizimit të arsimit. Kryedemokrati Basha duke shpallur problematikat ku ndodhet sistemi arsimor në vend hodhi akuza të forta ndaj qeverisë, ndërsa ai pretmoi para pedagogëve dhe studentëve se PD e ka zgjidhjen për të rritur besimin tek arsimi publik. "Problemet kryesore të arsimit janë nënfinancimi dhe ky problem është rënduar pas 2015 me miratimin e Ligjit për Arsimin e Lartë. Kurrë s'na e ka marrë mendja se pas 28 vitesh do të vinim në një stad ku për t'u emëruar në arsim duhet të merren injorantë e njerëz me precedentë penalë veç se janë anëtarë të një sekti kriminal si "Rilindja". Kjo tani është kthyer në rregull, çka ka shkatërruar cilësinë e mësimdhënies dhe besimin e prindërve tek arsimi publik", -theksoi z.Basha.

Prokuroria e Kavajës i akuzon për falsifikim të tabelave të rezultatit të votave në qershor 2017

"Vjedhje votash", procedohen 10 komisionerë

Emrat, rinumërimi ka zbuluar tjetërsim të numrit të procesverbaleve

Dhjetë komisionerë, të cilët numëruan votat në qarkun e Tiranës janë proceduar penalisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pasi dyshohen se kanë falsifikuar tabelat e rezultatit të votave në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017-të.

"Gjatë hetimeve të kryera, ka rezultuar e provuara se anëtarët e komisioneve zgjedhore të sipërcituara, me dashje, kanë ndryshuar rezultatit e zgjedhjeve, pasi pas një procesi rinumërimi të votave nga ana e KQZ, kanë dalë rezultate të ndryshme nga ato të nxjerra nga këto komisione", - shprehet prokuroria e Kavajës në kërkesën për gjykim drejtuar gjykatës.

"Pavarësisht pretendimeve të anëtarëve të komisioneve për një gabim nrëzor, dukshëm rezultati është i ndryshëm, gjë që dëshmon vullnetin e tyre që me dashje të falsifikonin rezultatit e zgjedhjeve," shton organi akuzës.

Të pandehur nga ana e prokurorisë së Kavajës janë marrë shtetasit, Adriatik Kasa, Aldo Duro, Arnold Karriqi, Bujar Menolla, Ferdinand Saraçi, Idriz Dedej, Mediola Veliu, Rexhep Verrija, Shpendi Dema dhe Ylli Thartori.

Nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë, gjatë seancës para-praktë të mbajtur me 19 korrik 2018, të pandehurit kanë kundërshtuar hapjen e gjyqimit, duke pretenduar se hetimet nuk janë të plota, ndërkohë që kanë kërkuar gjithashtu gjykim të shkurtuar.

Avokati i Mediola Veliu i tha BIRN se procesi ishte politik. "Është një çështje që nuk e ka bërë prokuroria por politika", tha avokati Shkëlqim Sula.

Megjithatë, prapësimet e mbrojtës janë hedhur poshtë nga gjykata dhe kërkesa e Prokurorisë së Kavajës është pranuar nga gjyqtari Paulin Çera - komanduar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka vendosur hapjen e procesit gjyqësor për falsifikim të zgjedhjeve ndaj 10 komisionerëve.

RINUMËRIMI ZBARDH PROBLEMET

Pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura me 25 qershor 2017, komisionet e nivelit të dytë, KQZ-të kanë dorëzuar në KQZ tabelat përmblidhëse të rezultateve të zonave të administrimit zgjedhor, tabelat e rezultatit të qendrave të votimit të plotësuar nga grupet e numërimit, si dhe dokumentacionin zgjedhor.



Foto ilustruese

Kërkesa



DOSJA NE GJYKATE

Prokuroria e Kavajës ka përpiluar kërkesën për dërgimin e çështjes penale në ngarkim të tyre në gjyq. Pasi gjykata mori në shqyrtim kërkesën e prokurorit dhe provat, si dhe ka dëgjuar palët në seancë gjyqësore, gjyqtari Paulin Çera ka vendosur se prokurori "ka cilësuar drejt rrethanat e faktit".

Pas depozitimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet dhe Partia Socialiste kanë kërkuar rinumërimin e disa qendrave të votimit në qarkun e Tiranës. Sipas këtyre dy partive, pas administrimit të pamjeve filmike të procesit të numërimit të votave për të gjithë zonat zgjedhore të qarkut Tiranë është konstatuar se për disa qendra votimi numri i votave nuk përputhet me rezultatit e hartuar nga grupet e numërimit në tabelat e qendrave të votimit.

Pas marrjes së kësaj kërkesë, KQZ ka administruar dokumentacionin zgjedhor të përpunuar nga komisionet zgjedhore përkatëse dhe ka vendosur rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në qendrat e votimit. Nga ky proces ka rezultuar se në 5 nga 68 qendra votimi, rezultati ka dalë i ndryshëm me rezultatit e nxjerrë nga grupet e numërimit.

Ka rezultuar po ashtu se anëtarët e grupeve të numërimit që kanë numëruar votat për këto qendra, kanë shënuar në tabelën e rezultatit të grupit të numërimit një numër më të

vogël votash për disa subjekte dhe numër më të madh votash për disa subjekte të tjera.

Sipas KQZ-së rezultati i disa qendrave të votimit nuk ka pasqyruar rezultatit real të cilën zgjedhësit e këtyre qendrave kanë shprehur nëpërmjet votimit, duke favorizuar disa subjekte zgjedhore. Megjithatë, Komisioni nënvizon se këto ndryshime të konstatuara në tabelat e rezultatit janë në një masë të tillë që nuk kanë sjellë pasojë në rezultat apo në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zona zgjedhore.

Procedimi penal ndaj të dyshuarave me detyrë anëtarë, sekretar dhe numërues i parë i grupeve të numërimit në KQZ nr. 43, ka filluar pas kallëzimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 24 korrik 2017. Me datë 22 janar

2018, Prokuroria e Kavajës i ka njoftuar akuzën 10 të pandehurve.

Shkëlqim Sula, avokat mbrojtës i një prej komisionerëve të akuzuar tha se nuk bëhej fjalë për çështje penale, por një çështje politike, ai u ankua se gjyqi po vijonte për një kohë të gjatë. Është shtyrë shumë herë, ku në disa raste janë bërë shkak të pandehurit në disa të tjera, avokatët e disa raste prokurorët, që shkojnë në seminarë, tha Sula.

LODHJE, PAQJUMËSI DHE MIRËBESIM

Si pjesë e hetimit të çështjes prokuroria ka marrë në pyetje 10 të pandehurit, duke kërkuar të hedhë dritë mbi procedurën e plotësimit të tabelave të rezultatit të zgjedhjeve, përbërjen e grupeve të numërimit përkatëse,

RINUMËRIMI

Pas depozitimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet dhe Partia Socialiste kanë kërkuar rinumërimin e disa qendrave të votimit në qarkun e Tiranës. Është konstatuar se për disa qendra votimi numri i votave nuk përputhet me rezultatit e hartuar nga grupet e numërimit në tabelat e qendrave të votimit.

si dhe shpjegimet e tyre për ndryshimin e rezultati pas procesit të rinumërimit të votave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

TE PANDEHURIT

- Adriatik Kasa
- Aldo Duro
- Arnold Karriqi
- Bujar Menolla
- Ferdinand Saraçi
- Idriz Dedej
- Mediola Veliu
- Rexhep Verrija
- Shpendi Dema
- Ylli Thartori

REZULTATI

Sipas KQZ-së rezultati i disa qendrave të votimit nuk ka pasqyruar rezultatit real të cilën zgjedhësit e këtyre qendrave kanë shprehur nëpërmjet votimit, duke favorizuar disa subjekte zgjedhore. Megjithatë, Komisioni nënvizon se këto ndryshime të konstatuara në tabelat e rezultatit janë në një masë të tillë që nuk kanë sjellë pasojë në rezultat apo në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zona zgjedhore.

ja - anëtar i LSI-së, i cili ka shpjeguar se ai është i caktuar si numërues i fletëve të votimit në GNV nr. 2165, nr. 2173 dhe nr. 2194 me qendër në shkollën 9-vjeçare "Tre Dëshmorët" në Kavajë. Në të njëjtin grup numërimi kanë qenë dhe shtetasit Arnold Karriqi - përfaqësues i PD-së, Aldo Duro si përfaqësues i PS-së, si dhe Mediola Veliu si përfaqësues e PDIU-së. Lidhur me rezultatit e rinumërimit të votave të nxjerrë ndryshe nga KQZ, Verrija ka deklaruar se në tabelën e rezultateve për qendrat e votimit nr:2713 dhe nr:2194 nuk është nënshkrimi i tij. Ai ka shtuar se në qendër nr:2165 ka firmosur "në mirëbesim", pasi tabelat janë plotësuar nga përfaqësuesja e PDIU-së Mediola Veliu. Edhe shtetasit Aldo Doro dhe Arnold Karriqi kanë pretenduar se tabelat e përgatitura nga Mediola Veliu, i kanë firmosur në mirëbesim. Vetë Veliu ka deklaruar se ajo ka hedhur të dhënat në tabelë sipas numërimit që është bërë në prani të të gjithë anëtarëve të grupit, të cilët kishin nënshkruar pa vërejtje.

Si pjesë e hetimit prokuroria ka marrë në pyetje edhe shtetasin Adriatik Kasa, numërues në KQZ nr:43, GN 04 dhe QV nr:2241 me qendër në Rrogzhinë. Ai ka shpjeguar se pjesë e këtij grupit të numërimit kanë qenë dhe shtetasit Flamur Lika si përfaqësues i PD-së, Fatmir Bakalli i PS-së dhe Ylli Thartori përfaqësues i LSI-së. Në lidhje me ndryshimin e rezultatit pas rinumërimit të KQZ-së, Kasa ka shpjeguar se plotësimi i të dhënave në tabelë është bërë nga Flamur Lika dhe ai ka firmosur në mirëbesim.

Si pjesë e këtij procedimi prokuroria ka marrë në pyetje shtetasin Rexhep Verri-

Njoftim për shitje me ankand te II

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. në datë 01.02.2019 ka shpallur ankandin e dytë të pasurisë të palës debitore Shoqëria "ARNI" sh.p.k. Pauria që del në ankand të dytë përbëhet nga:

- Apartamenti "B" Nr pasurisë 69/11/ND +1-14 ndodh Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 13 Ap 14, Oriktum e regjistruar në ZVRPP- Vlore, Z K Nr.2832, volumi 16, faqe 120, me sipërfaq 43 m2.

Ankandi i pasurisë fillon me grimin fillestar në masën 1.344.000 lekë. Ankandi do të zhvillohet në datë 04.03.2019 në orën 15:00 në selinë Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontak: 0672082543, ilir_darvishaj@yahoo.com, faqen WEB www.powerjustice-sll.com.

Komisioni European: Shqipëria, rritje ekonomike prej 3.9% në 2019 dhe 2020

Reagon Ahmetaj: U konfirmua rënia e nivelit të borxhit publik

Ish-ministri i Financave: Rritje ekonomike mbi 4% për vitin 2018

Ish-ministri i Financave Arben Ahmetaj reagon pas publikimit të raportit të Komisionit European, i cili konfirmoi rritjen ekonomike mbi 4% për vitin 2018. Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave Arben Ahmetaj ka reaguar pas publikimit të raportit të Komisionit European për performancën ekonomike të vendeve kandidate dhe potencialisht kandidate në BE, në të cilin analizohen ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Turqinë. Në një postim në 'Facebook', Ahmetaj shkruan se raporti konfirmon rënien e nivelit të borxhit publik dhe se në vijim Shqipëria parashikohet të ketë rritjen më të lartë ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitet 2019-2020. "Komisioni European ka publikuar raportin tremujor për performancën ekonomike të vendeve kandidate dhe potencialisht kandidate në BE, në të cilin analizohen ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Turqinë. Lajmi i parë i mirë është se Shqipëria është një nga dy vendet e rajonit (së bashku me Malin e Zi) që kanë vazhduar rritjen pozitive të ekonomisë edhe përgjatë tremujorit të tretë 2018, në një kohë që vendet e tjera dhe mesatarja e rajonit shënojnë rënie"-shkruan Ahmetaj. Sipas kreut të Komisionit të Ekonomisë, Shqipëria parashikohet të ketë rritjen më të lartë ekonomike në Ballkanin Perëndimor përfshirë Turqinë, në 2019-2020. Papunësia në Shqipëri projektohet në nivelin më të ulët në rajon, pranë 10%, ndër-



Ish-ministri i Financave Arben Ahmetaj

KONSOLIDIMI FISKAL

Në kategorinë e zhvillimeve fiskale, Komisioni European përmend miratimin e buxhetit të vitit 2019 në parlament, që është i bazuar në performancën pozitive të vitit 2018, me një deficit fiskal prej 1.9% dhe një reduktim të borxhit publik në 65.5% të prodhimit të Brendshëm Bruto.

sa borxhi publik vazhdon të konsolidojë trajektoren rënëse. "KE konfirmon një rritje ekonomike mbi 4% për vitin 2018, njësoj sikurse vlerëson më herët edhe FMN apo Standard and Poor's. Rritja e konsumit pri-

vat, importeve dhe investimeve, vijojnë të kenë kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Performanca e fortë ekonomike vijon të reflektohet edhe në zhvillimet pozitive të tregut të punës. Pjesëmarrja në forcat e punës

| | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | ECFIN 2018 Autumn forecast | 2019 | 2020 | Q2 1 |
|--|------|------|------|------|-------|-------------------------------|------|------|------|
| Gross domestic product (in real terms, annual % change) | | | | | | | | | |
| Albania | 1.8 | 2.2 | 3.4 | 3.8 | 4.1f | 3.9 | 3.9 | 4.1 | 4.2 |
| The former Yugoslav Republic of Macedonia | 3.6 | 3.8 | 2.9 | 0.1 | 2.1f | 2.8 | 3.1 | 3.1 | 3.1 |
| Montenegro | 1.8 | 3.4 | 2.9 | 4.7 | 3.9f | 2.8 | 3.1 | 4.1 | 4.1 |
| Serbia | -1.6 | 1.8 | 3.3 | 2.0 | 4.4f | 3.8 | 3.8 | 4.1 | 4.1 |
| Turkey | 5.2 | 6.1 | 3.2 | 7.4 | 3.8f | -1.5 | 3.0 | 5.1 | 5.1 |
| Bosnia and Herzegovina | 0.6 | 4.1 | 3.4 | 3.4 | - | - | - | - | - |
| Kosovo | 1.2 | 4.1 | 4.1 | 4.2 | - | - | - | - | - |
| Unemployment | | | | | | | | | |
| Albania | 17.9 | 17.5 | 15.6 | 14.1 | 12.7f | 11.1 | 10.6 | 12 | 12 |
| The former Yugoslav Republic of Macedonia | 28.0 | 26.1 | 23.8 | 22.4 | 21.3f | 20.6 | 20.1 | 21 | 21 |
| Montenegro | 18.2 | 17.8 | 18.0 | 16.4 | 15.5f | 14.9 | 14.6 | 14 | 14 |
| Serbia | 19.2 | 17.7 | 15.3 | 13.5 | 13.1f | 12.0 | 10.9 | 11 | 11 |
| Turkey | 10.1 | 10.5 | 11.1 | 11.1 | 10.1f | 12.8 | 12.7 | 10 | 10 |
| Bosnia and Herzegovina | 27.5 | 27.7 | 25.4 | 20.5 | 18.4 | - | - | - | - |
| Kosovo | 35.3 | 32.9 | 27.5 | 30.5 | - | - | - | - | - |

Të dhënat e KE-së

në tremujorin e tretë 2018 është në nivelin 68.3% krahasuar me 67.1% që ishte një vit më parë. Punësimi në sektorin jobujqësor është rritur me 7.5%, ndërsa papunësia ka shënuar nivelin më të ulët nga viti 2012"-shkruan Ahmetaj. Ish-ministri komenton edhe vlerësimet e raportit në lidhje me punësimin dhe rritjen e pagave. "Punësimi për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është përshejtuar në 26% krahasuar me një vit më parë, ndërsa papunësia për këtë grupmoshë ka vijuar trendin rënës nga piku prej 34% i vitit

2015. Pagat në sektorin privat vlerësohet të jenë rritur me një mesatare plus 15 pikë në të gjithë sektorët, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë"-shkruan Ahmetaj në postimin e tij. Më tej, kreu i Komisionit parlamentar të Ekonomisë vlerëson se raporti i Komisionit European për ekonominë shqiptare, "është një tjetër refleksion serioz për arritjet jo pak të vështira të viteve të fundit". Sipas tij, sfida kryesore mbetet vazhdimi i reformave dhe konsolidimi fiskal, për të garantuar jo vetëm vazhdimin e rritjes

ekonomike dhe punësimin, por edhe përgjigjen e duhur ndaj riskut të ngadalësimit të rajonit dhe ekonomive të BE.

RAPORTI

Komisioni European ka publikuar raportin e fundit mbi projektet ekonomike, për vendet kandidate që synojnë të bëhen pjesë e unionit, për tremujorin e katërt të vitit 2018. Ashtu si në projektet e vjeshtës, Komisioni European parashikon një rritje ekonomike prej 3.9% për Shqipërinë, gjatë këtij viti dhe gjatë vitit të ardhshëm. Në kategorinë e zhvillimeve kryesore, Komisioni përmend vetëm protestën e studentëve kundër qeverisë, që çuan në shkarkimin e ministres së Arsimit, ministrin të Financave dhe Ekonomisë dhe gjashtë ministrave të tjerë. Për sa i përket punësimin, krahu ekzekutiv i Bashkimit European deklaroi se ky treg ndoqi tendencën e zgerimit ekonomik. Përgjatë tremujorit të tretë të vitit të kaluar, rritja e përgjithshme e punësimin mes moshës nga 15-64 vjeç rezultoi në rritje me 1.8%, në rang vjetor, ndërsa punësimi në sektorin privat, me përjashtim të bujqësisë u rrit me 7.5%.



Dështon taksa e banesës

Haxhimali: Bashkitë nuk kanë sqaruar qytetarët

E dhe pse nuk është marrë një vendim konkret për shpërbërjen e mblendjes së taksës së banesës në bazë të metodologjisë së re duket se procesi ka dështuar. Agron Haxhimali kreu i shoqatës së bashkive deklaroi se ky ligj duhet të hynte në fuqi që në datën 1 prill. "Ishte lënë afati 1 prill 2018. Nuk ka asnjë afat tjetër me ligj që ka përcaktuar shtyrjen e kësaj date për vjeljen e kësaj takse. Çdo afat tjetër i diskutuar do nisë më 1 janar, siç ju i referoheni Ministrisë së Financave nuk është asgjë më shumë sesa një opinion, diskutim mediatik"-thotë për OraNews Agron Haxhimali. Shqetësim mbetet edhe fakti që qytetarët nuk kanë marrë një sqarim konkret në lidhje me të gjithë procesin. "Jemi në një moment jashtëzakonisht të dobët sa i takon komunikimit dhe informimit të qytetarëve për mënyrën si dhe sa duhet ta paguajnë këtë taksë",- Agron Haxhimali. Mungesa e të dhënave duket se ka qenë një nga arsytet kryesore në mosaplikimin e kësaj takse, e cila në shumë bashki vijon të mblidhet me metodën e vjetër. Afrimi i zgjedhjeve vendore duket se do të shtyjë edhe për disa muaj pagesën e taksës së banesës në bazë të vlerës.

Ministrja inspekton 'Rrugën e Arbrit' Balluku: Cilësia e punimeve të jetë kryesore



ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, gjatë inspektimit të 'Rrugës së Arbrit'

10 vjet, kështu që cilësia është absolutisht një nga kërkesat kryesore, por që dhe juve do t'ju duhet për vazhdimësinë. Shpresojmë të mbarojmë përpara afatit për t'ia dhënë shqiptarëve këtë arterie jashtëzakonisht të rëndësishme sa më parë në përdorim",-është shprehur ministrja Balluku. Ura e Vashës lidh dy

tunelet T5 dhe T6 në dy shtatet e malit. Ura përbëhet nga konstruktion metalik në një hark rihet. Ka 27 kolona paralele në të dyja anët e urës, të cilat ngrihen drejt lart. Ura ka një gjatësi hapësirë drite 160 metra, pjesa e kalueshme mbi konstruktion metalik është 220 metra, ndërkohë që vetë ura është

242 metra. E gjithë pjesa e rrugës së Arbrit që ka mbetur për t'u ndërtuar është 54 km, në të cilën koncesionari ka realizuar më shumë se 28% të punimeve. Në bazë të kontratës rruga duhet të përfundojë brenda 44 muajsh, por me volumin e kryer dhe me angazhimin e koncesionarit pritet që rruga të përfundojë më herët.

PUNIMET

"Rruga e Arbrit është një veper shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të zonës. Gjëja më e rëndësishme është që duhet të përfundojë në kohë, duhet të përfundojë me cilësi.

EKSPORTI



Shtetet që konsumuan "shqip"

Lista me 10 vendet kryesore, Italia në krye

Italia është edhe blerësi i kryesor i produkteve shqiptare blegtorale, bujqësore dhe agro-industriale. Rreth 8.6 miliardë lekë është llogaritur vlera e eksporteve gjatë vitit 2018 dhe në sasi, 22.3 mijë tonë

produkte janë tregtuar në këtë shtet. Por, pavarësisht se renditet në vendin e parë, eksportet drejt këtij vendi kanë pësuar një rënie të lehtë krahasuar me 2017-ën. TV SCAN ka zbardhur listën e 10 shteteve kryesore ku

eksporton më shumë produkte të këtij sektori, ku pas Italisë, e dyta renditet Kosova dhe Greqia me rreth 2.9 miliardë lekë apo 74.4 mijë tonë. Produktet shqiptare duket se kanë gjetur tregje të mira edhe në Suedi

që renditet në vendin e tretë, Serbi, SHBA, Gjermani, Spanjë, Rumani, dhe Maqedoni, me vlerë mbi 1 miliardë lekë. Peshën kryesore në eksporte e zënë perimet, frutat, arrorët, ujërat. Eksportet bujqësore për vitin 2018 janë regjistruar në 33.8 miliardë lekë, nga 31.5 miliardë lekë që kanë qenë në vitin 2017, me një rritje prej 2.3 miliardë lekë.

Aktet e Marrjes së Tokës në Përdorim do të shndërrohen në certifikata pronësie

Tokë me 7501, Lame: Aksion për tapitë për tokat bujqësore

Përfundon procesi i legalizimeve në Pezë

Qeveria shqiptare do të nisë një "aksion" për regjistrimin e tokave bujqësore të përdara me ligjin 7501. Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi do të shndërrohen në certifikata pronësie brenda dy viteve. Lajmi është bërë i ditur nga kreu i ALUIZNI-t Artan Lame dhe gjatë një takimi, ku shpërndau lejet e fundit të legalizimit në Pezë. Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t tha se, "pas legalizimeve nis aksioni i madh i këtij mandati të qeverisë, që është regjistrimi i tokave bujqësore, i AMTP-ve. Ky është aksioni i madh i radhës, që kërkon njësinë vendore të impenjohet për të vazhduar procedurat, është aksion që kërkon legjislativin të impenjohet". "Na besoni dhe siç mbyllim aksionin e madh të legalizimeve do të mbyllim dhe aksionin e regjistrimit të tokës bujqësore", premtoi Lame duke vënë theksin në rëndësinë që ka bujqësia për zhvillimin ekonomik të vendit.

TAKIMI

Peza është zona e parë në Tiranë që përfundon procesin e legalizimeve. Në një aktivitetet të zhvilluar në këtë njësi administrative, ALUIZNI dha lejet e fundit që përmbyllin kështu një proces të gjatë në kohë dhe të gjërë në problematikë. Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Artan Lame tha se, "ALUIZNI e kreu rolin e vet në historinë e tranzicionit shqiptar dhe, tashmë duke përmbyllur radhë pas radhë procesin e legalizimit, po shkon drejt shuarjes së vet". Duke sjellë në vëmendje faktin se, deri në 2013 në të gjithë zonën e Pezës nuk është bërë as edhe një legalizim, Lame sqaroi se, "i gjithë stoku prej 833 objekteve në këtë zonë të kryeqytetit u trajtua në këto 5 vite e fundit, siç u trajtua dhe po vazhdon të trajtohet në të gjithë Shqipërinë". "U përmbyll me sukses ky proces edhe për faktin se e gjithë popullsia e kësaj zone u impenjua që të bashkëpunonte me punonjësit tanë për ndjekjen dhe plotësimin e dokumentacionit", -tha kreu i ALUIZNI-t, në prani edhe të deputetit të zonës Arben Pëllumbi, duke përmendur



Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame, dhe gjatë një takimi në Pezë

se, "kur në 2013 Partia Socialiste dha premtimin për përmbylljen e procesit të legalizimeve është thënë gjithmonë, legalizim falas dhe legalizim i çdo objekti të legalizueshëm". Sipas Lames, ka dhe objekte që nuk mund të legalizohen apo objekte që

do të presin ndryshime ligjore nëse do të jetë e mundshme.

LIGJI I RI

Legalizimi i ndërtimeve pa leje, përfshirë marrjen e pronësisë së truallit, do të funksionojë sipas parimit të dritares unike. Ndryshe nga

NDËRTIMET PA LEJE

Në vitin 2013, kur në krye të ALUIZNI-t erdhi Artan Lame, agjencia identifikoi 270 mijë vetëdeklarime. Lista e zonave të palegalizuara përfshin Durrësin me 37 mijë ndërtime, Fierin me 27 mijë, Vlorën me 24 mijë, Elbasanin, 24 mijë, Korçën, 11 mijë, etj. Ndërkohë që u evidentuan rreth 80 mijë ndërtime pa leje, të tipit shtesa pallatesh.

tani, ku ky proces kalon në 3 institucione shtetërore, si ALUIZNI, Hipoteka dhe Agjencia e Pronave, ligji i ri që është miratuar ia transferon të gjitha këto kompetenca Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Do të jetë ky institucion, që evidenton

PERFUNDIMI I PAJISJES ME TITIJ PRONËSIE

- NENI 10 i ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë parashikon edhe procedurën e pajisjes me certifikatë pronësie të tokave të përfuturave me ligjin 7501. Kushtet për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore.
 1. Përfuturorë kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, subjektet që plotësojnë, njëkohësisht, këto kushte: a) Kanë qenë legjitimuar për të përfutur tokë sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.255, datë 2.8.1991, nr.452, datë 17.10.1992, apo vendimeve të veçanta, pavarësisht nëse kanë ndryshuar vendbanimin pas datës 1.10.1992. Këtu përfshihen edhe subjektet, që, sipas informacionit të gjendjes civile, kanë ardhur me banim në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore pas datës 1.8.1991 si dhe banorët jopunonjës të ish-kooperativave bujqësore;
 - b) Nuk kanë përfutur tokë bujqësore në territorin e ndonjë kooperative apo ndërmarrjeje bujqësore tjetër;
 - c) Përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë paraqitur kërkesë pranë organeve kompetente për plotësimin me AMTP për tokat e ish-kooperativave bujqësore apo ish-ndërmarrjeve bujqësore ose janë pajisur me aktin e marrjes së tokës në përdorim;
 - ç) Janë përdorues faktikë të tokës bujqësore.

Qendrat "One Stop Shop", 18,854 aplikime nga qytetarë e biznese

Administrata Tati më fton të gjithë të interesuarit t'i drejtohen qendrave të integruara me një ndalesë për të zgjidhur çdo problem të mundshëm. Drejtoria e Përgjithshme e Tati-meve bën me dije se gjatë vitit 2018 përmes këtyre qendrave janë bërë plot 18,854 aplikime nga qytetarë e biznese. Paralelisht me aplikimet 8,700 persona janë asistuar me infor-



macion dhe konsulencë të ndryshme lidhur me procedurat tatimore, ndërkohë që sipas Drejtorisë së Përgjithshme, në këtë mori aplikimesh nuk është regjistruar asnjë ankesë. Aktualisht, sportele të administratës tatimore në qendrat e integruara gjenden në qytetet Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë. Për këtë vit, një mënyrë e re veprimi është konceptuar e filluar të zbatohet dhe konkretisht ajo e shërbimit të tatimpaguesve në ambientet e vendndodhjes së bizneseve.

ndërtimin pa leje, administron dokumentacionin e kërkuar, si dhe kryen procedurën e legalizimit brenda një periudhe dy mujore. Me miratimin e legalizimit, pronari i ndërtimit bëhet automatikisht pronar edhe i truallit, i cili si rregull nuk mund të jetë më i madh se 500 metra katrorë, përveç rasteve të veçanta si ndërtime me funksion social-ekonomik, ku truallit që kalohet në pronësi mund të jetë deri në trefishin e sipërfaqes së ndërtimeve. Por, ky parim vlen vetëm për tokën shtetërore. Ata që kanë ndërtime mbi tokë të zënë, e cila u përket të tretëve, do të marrin në pronësi truallin

vetëm pasi të ketë hyrë në fuqi vendimi i qeverisë për kompensimin e pronarëve të tokës. Deri në atë moment, ndërtimi i legalizuar regjistrohet pa marrëdhënie me truallin. Sipas ligjit, procesi i legalizimeve nuk do të ndërpritet në asnjë rast, edhe atëherë kur ka konflikt pronësie për tokën mbi të cilën është ndërtuar objekti. Agjencia e Kadastrës e legalizon ndërtimin, ndërkohë që qeveria ngrin në një llogari të veçantë kompensimin e pronarëve. Pas zgjidhjes së konfliktit të pronësisë në gjykatë, kompensimi i kalon automatikisht individit që njihet si pronar nga gjykata.

Ja pesë gjyqtarët e rretheve që e shpëtuan nga burgimi i përgjeshëm

"Dajti", prokuroria rekurs në Gjykatën e Lartë: Të priset vendimi i Apelit

Organi i akuzës kundër gjykimit të shkurtuar

TIRANË

Një ditë pas vendimit të marrë nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda në Tiranë, e cila pranoi gjykimin e shkurtuar, duke dënuar me 25 vite burg Dritan Dajtin për vrasjen e katër efektivëve të policisë në gusht të vitit 2009, ka ardhur reagimi i organit të akuzës. Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda dje bëri me dije se do bëjë rekurs. Mësohet se organi i akuzës është në pritje të zbardhjes së vendimit, i cili rrezoi atë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e cila në vitin 2014 (pas 276 seancash gjyqësore) e kishte dënuar me burgim të përgjeshëm Dajtin. Rekursi për çështjen e Dajtit do të bëhet në Gjykatën e Lartë, ku do të kërkohet prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Gjithashtu, Gjykatës së Lartë do t'i kërkohet që çështja të rigjykohej po nga Apeli, por me një trupë tjetër gjyqësore. Prokuroria thotë se ishin kundër pranimit të kërkesës së të pandehurit për pranimin e gjykimit të shkurtuar, gjë e cila e shpëtoi nga dënimi kapital me burg të përgjeshëm. Seanca gjyqësore në Apelin filloi në orën 09:00 të së premtës, ndërsa vendimi përfundimtar i pesëshes së gjyqtarëve u dha në orët e pasdites, duke mbyllur kështu një nga proceset më të gjata gjyqësore dhe të shoqëruar me bujë. Gjykimi i shkurtuar i ka dhënë të drejtën Dritan Dajtit të përfillojë nga ulja e dënimit me 1/3-ën. Çështja



Dritan Dajti

TRUPI GJYKUES I DRITAN DAJTIT

1. Fuat Vjerdha, kryesues, nga Gjykata e Apelit Shkodër
2. Lindita Hoxha, anëtar, nga Gjykata e Apelit Vlorë
3. Aleks Nikolli, anëtar, nga Gjykata e Apelit Vlorë
4. Petrit Aliaj, anëtar, nga Gjykata e Apelit Shkodër
5. Skënder Damini, anëtar, nga Gjykata e Apelit Shkodër

është gjykuar nga gjyqtarë, të cilët vinin nga Apeli e Rretheve, ndërsa vendimi u dha pas disa seancash shtyrje për mosformim të trupit gjyqësor. Për shkak të "konsumimit" të gjyqtarëve të Tiranës, procesi ndaj Dajtit mbeti në dorën e 5 gjyqtarëve të deleguar nga rrethet. Gjyqtarët që vendosën të dënojnë me 25 vite burgim Dritan Dajtin, duke prishur kështu vendimin me burgim të përgjeshëm të dhënë nga Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë janë: Fuat Vjerdha (kryesues i trupit gjyqësor), i cili rezultoi të jetë dhe kryetar i Gjykatës së Apelit në Shkodër. Ndërsa,

dy anëtarët Lindita Hoxha dhe Aleks Nikolli, janë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkodër. Pesëshja e gjyqtarëve plotësohej dhe me dy gjyqtarë të tjerë Petrit Aliaj dhe Skënder Damini, të cilët janë gjyqtarë të Apelit në Vlorë. Pak kohë më parë ishte Gjykata e Lartë që ktheu dosjen për rigjykim në Apeli për shkelje procedurale. Dritan Dajti u prangos dhjetë vite më parë dhe u vu nën akuzë për veprën penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", kryer ndaj punonjësit të policisë: Fatos Xhani, Sajmir Duçkollari, Altin Dizdari, Kastriot Feskaj, Ndërkohë, ai i ka mohuar

akuzën duke deklaruar se qëllimi me armë për t'u vetëmbrojtur pa e ditur se ata ishin policë. Në atë ngjarje mbeti i vrarë edhe shoku i Dajtit, Ledion Mara si dhe një pushues. Në asnjë seancë gjyqësore Dritan Dajti nuk ka pranuar që t'i ketë vrarë katër punonjësit të policisë me një qëllim, por ai ka theksuar se në përlëshje e asaj dite është vetëmbrojtur për shkak se ishte hapur një luftë dhe qëllonin në drejtim të tij. Deri në momentin e arrestimit pak minuta pas masakrës ku mbeti edhe vetë i plagosur, Dritan Dajti kishte qenë në liri pas arratisë nga Gjykata e Tiranës në verë të vitit 2004.



Vetingu/ Përzgjidhen anëtarët që do kalojnë në "sitë" policët

TIRANË - Përzgjidhen anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik për vetingun në polici, Gardë e SHÇBA. Përzgjedhja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik i hap rrugë nisjes së procesit të vetingut nga niveli i lartë drejtues për rreth 300 drejtues në Polici, Gardë e SHÇBA. Më tej procesi i vetingut do të përfshijë gjithë strukturat në çdo nivel. Bordi i Përzgjedhjes, në mbështetje të nimit 9, 10, të ligjit nr.12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA, në Ministrinë e Brendshme", VKM nr. 14, si dhe pas përfundimit të procedurës, përzgjedhni anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit: Ana Kapaj, Artur Bakur, Marjeta Gjellaj, Sonila Kadareja, Viktor Bërdo. Nga kandidaturat e përcjella nga Rektorati i Universitetit të Tiranës u përzgjedhën kandidatët: Ela Kërka, Elda Kuka (Balili), Elida Liko, Ledion Rusta, Mirela Ujkani (Miti). Anëtarë zëvendësues të anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit u përzgjedhën kandidatët, sipas renditjes: Nertila Sadedini (Murati), Bledar Ilija, Arta Lleshi, Elton Muça. Anëtarë të Sekretariatit Teknik u përzgjedhën kandidatët: Amarildo Kurti, Arta Lleshi, Eralda Bajollari, Erjona Bashari, Erlisa Shkodrani, Floris Muho, Gent Pejo, Gëzim Selmani, Ilva Mitro, Iva Guçe, Klevis Hajdini, Marjana Çela, Marjeta Përlala, Suela Pashaj, Laert Elmazaj. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka caktuar si anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, punonjësit: Elvira Dabërdaku, inspektor, Adriana Meko, inspektor, Besnik Hodo, inspektor, Anëtarë zëvendësues janë: Dhimitrulla Spiro, inspektor, Vjollca Koçollari, inspektor.

Vrau punonjësin e HEC, identifikohet autori

PUKE - Policia e Pukës ka identifikuar autorin e vrasjes së 30-vjeçarit Petrit Biba, ngjarje kjo e ndodhur më 25 vjeç. Burime pranë grupit hetimor bëjnë me dije për "GSH" se vrasja ka ndodhur nga pakujdesia. Dy të rinjtë; viktima dhe autori të dy nga Mirdita ishin punonjës në HEC-in e Vrrithit, ndërsa armën që mbanin e kishin pa leje. Pas krimit, 25 vjeçari u largua nga vendngjarja. Ndërsa i riu Biba pas plagëve të marra u dërgua me urgjencë në spitalin e Shkodrës, por nuk mundi t'u mbyllte plagët. Policia po punon për kapjen e tij dhe për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

Post Title: Project Assistant
Type of Contract: Service Contract (SC)
Project: Strengthening human resources, legal frameworks, and institutional capacities to implement the Nagoya Protocol (Global ABS Project)
Duty Station: Tirana, Albania
Duration of Assignment: one year with possibility of extension
Deadline for Application: February 21, 2019
Job Description: <http://al.undp.org>
 Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>.

Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

Post Title: Technical Specialist - Maritime
Type of Contract: Service Contract (SC)
Project: Enhancing the Development of Albanian Maritime Sector through Technical Assistance and Increased Partnership
Duty Station: Tirana, Albania
Duration of Assignment: one year with possibility of extension
Deadline for Application: February 21, 2019
Job Description: <http://al.undp.org>
 Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>.

Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

Prokuroria nis hetimet për stafin pedagogjik të shkollës "Rilindja" dhe DAR

Skandali në Kavajë, 14-vjeçarja dëshmon për 3 orë e gjysmë para gjykatës së Durrësit

Seanca e marrjes në pyetje është ndjekur përmes monitorit nga avokatët mbrojtës të djemve të arrestuar

Klodiana Haxhija

DURRËS

Pak ditë pas dhënies së masës së sigurisë "Ar rest me burg" ndaj nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Rilindja" në Kavajë, dje ka dëshmuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Durrësit 14-vjeçarja që u abuzua seksualisht. Ajo mbërriti të shtunë në gjykatën e qytetit bregdetar për të rrëfyer tmerrin që përjetoi për katër muaj me radhë. Me kërkesën e prokurorisë, togat e zeza vendosën sigurimin e padisë, pra pyetjen e të dëmtuarës, dëshmia e së cilës do të përdoret si provë në procesin ndaj 8 të akuzuarve, apo personave të tjerë që mund të rezultojnë të implikuar në krimin tronditës. Ky veprim hetimor u krye, për të shmangur çdo tentativë të mundshme për kërcënimin e të dëmtuarës, që të tërhiqej nga dëshmia, si dhe për shkak të moshës, traumave që ka kaluar e minorenja, që mund t'i zbehte kujtesën. Seanca për pyetjen e 14-vjeçares zgjati rreth 3 orë e gjysmë dhe në disa raste gjykata është detyruar ta ndërpresë atë, pas shqetësimeve të shfaqura nga ana e të abuzuarës. Në dëshminë e saj 14-vjeçarja u ka qëndruar deklaratave të saj të dhëna edhe në polici. Seanca e marrjes në pyetje është ndjekur përmes monitorit edhe nga avokatët mbrojtës të djemve, të cilët ndodhen tashmë pas hekurave. Vajza bashkë me prindërit trokiti në dyert e policisë, më 29 janar, pasi ishte abuzuar nga një grup djemsh që e shantazhuan me një video intime. Ndërkaq, prokuroria e Durrësit thellon hetimet lidhur me rastin e 14-vjeçares në Kavajë, e cila u abuzua seksualisht nga shokët e shkollës.

HETIMET

Krahas hetimit për të dyshuarit, organi i akuzës ka shtrirë hetimet edhe mbi stafin pedagogjik të shkollës "Rilindja" që frekuentonte vajza si dhe Drejtorinë Arsimore në Kavajë. Kjo për faktin se institucioni arsimor, u informua për skandalin dhe për pesë ditë me radhë heshti duke mos denoncuar krimin në polici. "Hetimet ndaj shkollës janë duke u kryer me përparësi", tha një burim i prokurorisë për "Gazeta Shqiptare" dhe "New24". Për skandalin e abuzimit të minorenes kanë përfunduar në pranga 7 persona, ndërsa një tjetër është në kërkim. Në dokumentin zyrtar thuhet se shkolla u vu në dijeni të skandalit, e megjithatë mësuesja kujdestare, drejtoresha e institucionit dhe psikologja, u mjaftuan vetëm me informimin e nënës së vajzës dhe takimin me të, por nuk bënë denoncim në polici, sikurse kanë detyrimin ligjor. Në vendim thuhet se mësuesja

KËRKESA

Me kërkesën e prokurorisë, togat e zeza vendosën sigurimin e padisë, pra pyetjen e të dëmtuarës, dëshmia e së cilës do të përdoret si provë në procesin ndaj 8 të akuzuarve, apo personave të tjerë që mund të rezultojnë të implikuar në krimin tronditës. Ky veprim hetimor u krye, për të shmangur çdo tentativë të mundshme për kërcënimin e të dëmtuarës, që të tërhiqej nga dëshmia, si dhe për shkak të moshës, traumave që ka kaluar e minorenja, që mund t'i zbehte kujtesën



Shkolla "Rilindja" në Kavajë

DËSHMIA

Seanca për pyetjen e 14-vjeçares së abuzuar seksualisht zgjati rreth 3 orë e gjysmë dhe në disa raste gjykata është detyruar ta ndërpresë atë, pas shqetësimeve të shfaqura nga ana e të abuzuarës. Në dëshminë e saj 14-vjeçarja u ka qëndruar deklaratave të saj të dhëna edhe në polici. Seanca e marrjes në pyetje është ndjekur përmes monitorit edhe nga avokatët mbrojtës të djemve, të cilët ndodhen tashmë pas hekurave.

"Kavaja", Spiropali: Pse publikuam vizitën në shtëpinë e vajzës

TIRANË - Ndërsa dy ditë më parë opinioni gjykoi videon e kryeministrit Rama, i cili zbuloi me zë e figurë prindërit e vajzës së abuzuar në Kavajë, ministria Elisa Spiropali ka sqaruar përmes një postimi në Facebook arsyes pse e publikuan videon. "...të nesërmen më ra telefoni dhe në emër të prindërve të vajzës, gjyshi më ftoi në shtëpi, vorbulla e dilemës u rikthye edhe më e fortë. Ty të faleminderit edhe njëherë tha, po ne s'jemi të qetë! Nuk na mjafton se po na del shpirti nga sulmet e tyre që po na e tresin vajzën para syve! Duam të bëjmë një apel publik, por nuk duam të merremi as me ndërmjetësit që na çojnë ata të opozitës as me ata që na vrasin natën nëpër studio dhe na qajnë ditën, duke na u lutur të dalim me ta në televizor", - shprehet Spiropali. Ndërsa, shton se pasi i nxorën me zë e figurë prindërit ka marrë një telefonatë falënderuese prej gjyshit të 13-vjeçares. "Telefonata e gjyshit pasi u publikua biseda jonë ishte kapaku që s'mund të mos e ndaja sot me të gjithë. Mos u mërzit për çfarë do dëgjosh më tha, neve s'ta harrojmë që na dhe mundësinë të çlirohemi! Pas gjithë këtyre ditësh e netësh terrori ku të gjithë kanë folur ç'kanë dashur për ne, ne sot folëm në emrin tonë. Ne nuk kemi frikë nga fytyra jonë dhe jemi krenarë për vajzën tonë, ndërsa turpin le ta mbajnë ata që dihet kush janë".



Publikimi i videos me prindërit e minorenes, Komisioneri: Do bëjmë vlerësimin sipas ligjit

TIRANË - Ndërkohë që media gjatë gjithë trajtimit të ngjarjes së Kavajës u kujdes të mos nxjerrë asnjë element që do identifikonte të miturën dhe familjen e saj, gabimin e bëri vetë kryeministri. Pasditën e së premtes, Rama publikoi në faqen e tij të Facebookut një video të realizuar gjatë vizitës së ministres Elisa Spiropali në familjen e vajzës. Në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e viktimave të abuzimit seksual, në video publikohen me fytyrë prindërit e vajzës, duke bërë që edhe vajza të identifikohet me lehtësi. "News24" iu drejtua kreut të Mbrojtjes së të Dhenave Personale, Besnik Dervishi për një qëndrim lidhur me këtë rast. Zyra e Komisionerit bën me dije se është njohur me ngjarjen nëpërmjet medias.



Kreu i Mbrojtjes së të Dhenave Personale, Besnik Dervishi

DEKLARATA E PLOTË

Zyra e Komisionerit, ashtu si edhe për të gjitha rastet e tjera, do të bëjë vlerësimin e duhur të çështjes, në raport me parimet dhe dispozitat e ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhenave personale", i ndryshuar. Në rast se do të konstatohen elementë të shkeljes së tij, do të ndiqen procedurat ligjore të hetimit administrativ, në përfundim të

të cilave do të dilet me aktin përkatës. Zyra e Komisionerit e konsideron shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me organet e medias, në funksion të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, ku bën pjesë edhe mbrojtja e të dhenave personale, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.


kujdestare u vu në dijeni të skandalit nga pastuesja e shkollës, pasi kjo e fundit kishte gjetur një mesazh në telefonin e të birit, të cilit njëri nga shokët e shkollës, i kërkonte që t'i gjente një vend që të kryente marrëdhënie me të miturën. Pastuesja mësoi se vajza shantazhohej me një video intime

dhe njoftoi mësuesen. Pas njoftimit, mësuesja e thirri nxënësen minorene, duke i kërkuar t'i fliste për marrëdhënien me një nga djemtë e klasës. Në bisedë, vajza i ka rrëfyer asaj se ishte abuzuar seksualisht nga disa prej djemve të shkollës, të cilët e kërcënonin me publikimin e pamjeve filmike, në

të cilat shfaqej duke kryer marrëdhënie me të dashurin e saj. Në këto kushte, mësuesja thirri nënën e vajzës dhe në prani të drejtoreshës e psikologes së shkollës, i ka treguar gjithçka kishte ndodhur. Institucioni u mjaftua me kaq. Heshti për ngjarjen, pasi nuk e denoncoi krimin tronditës në poli-

ci. Faktet në vijim, janë edhe më shokuese, për faktin se dy ditë më vonë, vajzën e telefonojnë nga shkolla dhe ajo bashkë me nënën shkon në institucion, ku takojnë mësuesen, psikologjen, drejtoreshën e shkollës dhe drejtoreshën e Arsimit. Vajza iu rrëfen atyre për të dytën herë

tmerrin që kishte përjetuar dhe se kishte tentuar të kryente edhe vetëvrasje. Zëri i të miturës ra në vesh të shurdhët, pasi edhe pse vetë drejtoresha e Arsimit, u vu në dijeni të abuzimit të fëmijës, në shkelje të ligjit e kaloi ngjarjen në heshtje, duke mos informuar policinë për ngjarjen.

 Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019 .


Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING"
The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 18 March 2019**.
Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com


**BRITISH AMERICAN
TOBACCO**

British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njofton se duke filluar nga data 5 Shkurt 2019, cmimet maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

| Nr | MARKA | Çmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë |
|----|----------------------------------|---|
| 1 | Kent Nanotek (Infina) | 320 |
| 2 | Kent HD Neo | 320 |
| 3 | Kent HD Infina | 320 |
| 4 | Lucky Strike NFF King Size 6 mg | 250 |
| 5 | Lucky Strike NFF Demislms 6 mg | 230 |
| 6 | Lucky Strike NFF King Size 4 mg | 250 |
| 7 | Rothmans Leggera | 250 |
| 8 | Rothmans of London (Blue) | 220 |
| 9 | Rothmans of London (Sky Blue) | 220 |
| 10 | Lucky Strike NFF Demislms 4 mg | 230 |
| 11 | Dunhill FC 7 mg | 330 |
| 12 | Dunhill FC 4 mg | 330 |
| 13 | Rothmans of London Demi 6mg | 220 |
| 14 | Rothmans of London Demi 4mg | 220 |
| 15 | Lucky Strike Double Capsule Wild | 250 |
| 16 | Eva Slims | 200 |

**Çmimet shprehen në Lek*

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

British American Tobacco Albania sh.p.k.
Tirane, Rr: "Kavajes", ish Kombinati Ushqimor
web: www.bat.com
office phone: +355 (0) 42 255084

BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**

**MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ**

**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID**

FALAS



Gjatë konferencës "Shëndeti, drejtësia sociale dhe ekonomike për të moshuarit në Shqipëri" në universitetin 'Luarasi'



Rektori Ethem Ruka: T'i ofrojmë një jetë sa me dinjitoze kësaj kategorie

Universiteti "Luarasi" organizon konferencë ndërkombëtare për problemet e të moshuarve

Voltiza Duro

Sipas raportit të OKB-së, Shqipëria renditet në grupin e dhjetë vendeve që ka pësuar plakjen më të shpejtë të popullsisë. Mbi 650 mijë të moshuar në vendin tonë përveç pensioneve të ulëta, përjetojnë edhe diskriminim moshor aktiv. Në kuadër të sensibilizimit dhe ofrimit të zgjidhjeve, universiteti 'Luarasi' në bashkëpunim me Shoqërinë Shqiptare për të Gjitha Moshat (ASAG), organizuan konferencën ndërkombëtare me temë "Shëndeti, drejtësia sociale dhe ekonomike për të moshuarit në Shqipëri". Të pranishëm në aktivitet ishin një sërë aktorësh si dhe deputetet Tatjana Nurçe, Nora Malaj e Grida Duma.

PROBLEMATIKAT

Drejtoresha ekzekutive e ASAG, Mira Pirdeni tregon disa nga problematikat e pensionistëve, ndër to dhe mungesën e një ligji për të moshuarit. "Të moshuarit vuajnë varfërinë e pensioneve të ulëta, e mungesës së ekskesit në shërbime. Qendrat ditore në Shqipëri janë shumë të limituara dhe jashtë standardeve. Madje nuk ka as ligj për të moshuarit, i cili të ketë të saktësuarat përfitimet e të moshuarve, burimet financiare dhe një këshill kombëtar që të orientojë politika, programe dhe donacione për të moshuarit", tha drejtoresha e ASAG.

SYNIMI

Rektori i universitetit, prof. dr. Ethem Ruka thotë se kjo konferencë ka si synim zgjidhjen e problematikave financiare të të moshuarve dhe ofrimin e një jete sa më dinjitoze për ta. "Ka një sërë problemesh të tjera që lidhen me plakjen e popullsisë në Shqipëri. Na bëjnë të mendojmë të gjithë për të gjetur zgjidhje jo vetëm për trajtimin financiar të moshës së tretë, por në radhë të parë për ta bërë jetën e tyre më dinjitoze. Detyra e universitetit është të shtrijë problemet për zgjidhje bashkë me sho-



Rektori i universitetit, prof. dr. Ethem Ruka dhe Monique Epstein, përfaqësuese e një prej organizatave më të fuqishme në Francë për mbrojtjen e të moshuarve

REKTORI

"Kjo konferencë ka si synim zgjidhjen e problematikave financiare të të moshuarve dhe ofrimin e një jete sa më dinjitoze për ta. Ka një sërë problemesh të tjera që lidhen me plakjen e popullsisë në Shqipëri".

qërinë civile dhe agjencitë e tjera. Ata që vendosin janë politikëbërësit", u shpreh Ruka.

MODELI FRANCEZ

Monique Epstein, përfaqësuese e një prej organizatave më të fuqishme në Francë për mbrojtjen e të moshuarve, thekson se problemet e kësaj kategorie në Shqipëri janë më të rënda se në shtetin francez. "Konstatova që problemet e moshës së tretë në Shqipëri janë më të rënda se në Francë. Misioni im i ardhjes këtu është që të sjell modelin francez dhe mekanizmat e duhura për ta bërë jetën e të moshuarve më të mirë edhe në vendin tuaj. Në Shqipëri ka probleme të shum-

ta me shtëpitë e të moshuarve, ndërsa modeli që përdorim ne në Francë është ai i vetmenaxhimit të azileve duke sjellë opsione për të rritur të ardhurat. Një problem tjetër është edhe komunikimi i të moshuarve me partnerët që u vijnë në ndihmë. Duhet të vendoset dialog me aktorët e tjerë në mënyrë që të moshuarit të mund të adresojnë problemet e tyre" tha Monique Epstein. Nëpërmjet kësaj konference, u evidentuan shqetësimet kryesore të të moshuarve në Shqipëri dhe u dhanë zgjidhje alternative në mënyrë që pensionistët të minimizojnë problemet ekonomike e të jenë aktivë në komunitet.

ORGANIZATAT E HUAJA

Monique Epstein, përfaqësuese e një prej organizatave më të fuqishme në Francë për mbrojtjen e të moshuarve, thekson se problemet e kësaj kategorie në Shqipëri janë më të rënda se në shtetin francez.



Invitation to Quote (ITQ)

Albania

World Bank Loan/Credit Name: Citizen Centric Service Delivery Project; 8521-AL

"Branding of ADISA windows in Municipalities' OSSHs" Ref: AL-8521/G/SH/2.13.09

- The Government of Albania has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development towards the cost of Citizen Centric Service Delivery Project and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for "Branding of ADISA windows in Municipalities' OSSHs"; Ref: AL-8521/G/SH/2.13.09.
- The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites to quote with regard to the items under this Invitation. Price quotations will be evaluated for all the items together and contract will be awarded to the firm offering the lowest evaluated total cost of the items. The prices should be quoted in ALL (Albanian Lek) for the Total Cost which includes all taxes, VAT, customs, duties, inland transportation and insurance, loading and unloading.
- The full Invitation to Quote document including Technical Specification may be found to ADISA website (www.adisa.gov.al) or requested at the emails below by interested suppliers. Quotation may be submitted by official mail, or electronically at the following address:

Project Management Unit
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te
Tirana, Albania
e-mail: roland.larashi@adisa.gov.al
and informacion@adisa.gov.al

- Interested suppliers may obtain further information at the same addresses.
- The deadline for submission of Quotation is **February 21, 2019, at 12:00 local time.**

IN MEMORIAM

LAMTUMIRË KIÇO BLUSHI!

Shkrimtari përcillet për në banesën e fundit

Fatmira Nikolli

Është përcjellë dje për në banesën e fundit, shkrimtari e skenaristi i njohur Kiço Blushi që u nda nga jeta të premtën në moshën 75-vjeçare.

Gjatë ditës së djeshme të shumë kanë qenë personazhet publike dhe miqtë që kanë ngushëlluar familjen e të ndjerit.

"Kiço ishte i veçantë për kurajën e tij, për mirësinë e tij. Ishte njeri i kualiteve, sepse ishte aktiv në disa fusha. Nuk ishte thjesht skenarist i filmi shqiptar, por skenaristi më i mirë i ekranit shqiptar", tha dje Leka Bungo. Ndërsa për Limoz Dizdarin, ai ishte "shkrimtar, poet, publicist, njohës shumë i mirë i karaktereve dhe shpirttrave njerëzore. Ishte qytetar i mençur dhe me dashuri të madhe për njerëzit".

Teksa ne i kujtojmë disa nga batutat e tij më të famshme të filmave që ai shkroi: "Shqipëria të bëhet e mosvare" (Nëntori i dytë); "Vetëm në Paris blihen lule me para", "këtu lulet i hanë gomerët" (Koncert në vitin 1936), botuesi Petrit Ymeri kujtoi se ai ka qenë një "njeri i angazhuar, këmbëngulës për të vërtetën... Këto janë karakteristika që sot nuk i gjejmë shpesh".

"Do na mungosh i dashur Kiço, por nuk do të harrojmë kurrë!

Kiço Blushi u nda nga ne të gjithë. Me shumë hidhërim u përballëm me këtë lajm të dhimbshëm për humbjen e një shoku, të një mikut, të shkrimtarit dhe publicistit qytetar e pasionant, gjithmonë luftëtar këmbëngulës i të vërtetës. Ky ishte Kiço Blushi për të gjithë, autori i mjaft librave dhe skenarist i shumë filmave të shquar që rritën brezat e rinj të shqiptarëve. Por Kiço ishte edhe shok i gëzuar e dashamir i të gjitha punëve të mira të kulturës, gjithmonë bashkë me ne në rrugën e bukur të librave. Jemi pranë Mirës, Benit dhe Martinut dhe gjithë të dashurve të tjerë, mbesa e nipër, në këtë humbje të madhe", shkruante dje në faqen e saj zyrtare, shtëpia Botuese "Dituria".

Ndërkaq, kryeministri Edi Rama në një status në rrjetet sociale tha se ai do të kujtohet gjithnjë me atë gjysmëqeshjen e tij kur hapnim një temë dhe thikën e mprehtë të gjykimeve pa gajle, për këdo e gjithkënd. "Kiço Blushi ishte një ndër ata personazhë të jetës artistike, letrare e shoqërore po ashtu, që dinë të qëndrojnë drejt edhe kur fryjnë erëra të forta përballë, po




edhe kur erërat që të çojnë artificialisht përpara të kërrusin si doqoftë. Sqimatar dhe ironik, Kiçua do të më kujtohet gjithnjë me atë gjysmëqeshjen e tij kur hapnim një temë dhe thikën e mprehtë të gjykimeve pa gajle, për këdo e gjithkënd. I paharruar qoftë kujtimi yt i dashur mik" shkroi kryeministri.

Edhe Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi shprehu ngushëllimet dhe vlerësimet për të. "Kiço Blushi ishte shkrimtari, dhe intelektual i angazhuar për një Shqipëri më të mirë dhe për të ndryshuar jetën e të gjithëve. Krijimtaria e shkrimtarit dhe artistit Kiço Blushi është shndërruar në pasuri të jetës së brezave të shqiptarëve. Kiço Blushi ishte deputeti dhe kolegu ynë në kohë të vështira dhe i dha fisnikëri Kuvendit të Shqipërisë. Kiço Blushi ishte mikut i të gjithëve dhe do na mungojë të gjithëve", tha Gramoz Ruçi.

**REXHEP QOSJA:
NDIKIMI QYTETAR**

Me pikëllim të madh e mësova lajmin për ndarjen nga jeta të shkrimtarit, skenaristit, publicistit dhe veprimtarit të shquar kulturor Kiço Blushi. Të gjithë ata që e njohën, të gjithë ata që e takuan, siç pata fatin ta njoh e ta takoj edhe unë, nuk do ta harrojnë kurrë. Me fjalën e tij gjithmonë të ndershme, gjithmonë të qartë e të vendosur, me përkushtimet e tij mendore e ndjenjore ndaj të drejtës e të vërtetës, ai ushtroi ndikim çlirues, përparues, qytetëruar, demokratizues në jetën e në krijimtarinë

*Qosja: Fjalët e ndershme që la pas,
Leka: Si e njoha unë Kiço Blushin*



shpirtërore shqiptare. Vepra e tij dhe emri i tij mbesin përgjithmonë në historinë e kulturës së popullit shqiptar.

Familjarëve, miqve e dashamirëve të tij të shumtë u shpreh ngushëllimet e mija më të thella.

MARTIN LEKA: PUNA ME TË

Kiço Blushi e "njoha" kur isha fëmijë. E njoha mbi një çarçaf të bardhë në qendër të fshatit tek projektonej filmi "Beni ecën vetë".

Më pas të tjerë skenarë filmash e librash, me konturuan Kiço Blushin në dimensionet e një shkrimtari të rëndësishëm në vendin tonë të vogël!

Me ardhjen e gazetës "Koha Jonë" në Tiranë, me Kiçon u bëmë dhe miq! Ishte njeriu tek i cili nuk njihje nocioni "ri apo i vjetër"! Ne të rinjtë turpëroheshim kur na

thërriste si koleg!

Me këshilla herë si mik, herë si shok e herë si prind, ne gazetaret e rinj mësuam shumë nga përvoja dhe bashkëpunimi me Kiçon!

Ka pafund çaste që duhen kujtuar, por mjaftojnë filmat dhe librat e kohës sonë për t'u përkulur me respekt e mirënjohje ndaj kujtimit të Kiço Blushit, këtij njeriu që la pas gjurmë të rëndësishme!

KUSH ISHTE KIÇO BLUSHI

Kiço Blushi ka lindur në qytetin e Korçës në 23 gusht të vitit 1943. Pas mbarimit të studimeve të larta për letërsi shqipe dhe ruse filloi punën si redaktor pranë Radio Televizionit Shqiptar dhe në vitin 1974 kalon si redaktor në Kinostudion "Shqipëria e Re".

Skenari i tij i parë ishte ai i filmi "Çifti i lumtur" në vitin 1975 si bashkautor. Me skenarin e filmi "Beni ecën vetë" në vitin 1975 u vlerësua me Çmimin e Republikës së Klasit të III-të. Autor i dhjetëra romaneve, dramave dhe tregimeve, skenarist i rreth 14 filmave, Blushi vazhonte të ishte një zë kritik në publicistikë me qindra e qindra artikuj dhe analiza kritike të botuara gjatë viteve të fundit në organe të ndryshme të medias. Kiço Blushi do të mbahet mend gjatë jo vetëm si autori e skenaristi i njerit prej librave dhe filmave më të dashur për shqiptarët "Beni ecën

Të gjithë ata që e njohën, të gjithë ata që e takuan, siç pata fatin ta njoh e ta takoj edhe unë, nuk do ta harrojnë kurrë. Me fjalën e tij gjithmonë të ndershme, gjithmonë të qartë e të vendosur, me përkushtimet e tij mendore e ndjenjore ndaj të drejtës e të vërtetës, ai ushtroi ndikim çlirues, përparues, qytetëruar, demokratizues në jetën e në krijimtarinë shpirtërore shqiptare.

vetë", por edhe për skenarët e filmave të tjerë lapidarë në kinematografinë shqiptare si "Nëntori i dytë", "Në shtëpinë tonë", "Koncert në vitin 1936", "Pylli i lirisë" apo komedia embleme "Çifti i lumtur". Pena e Kiço Blushit ka sjellë ndërkohë për lexuesit edhe dhjetëra tituj romanësh, novelash e tregimesh si dhe libra me poezi, si "Çatia e të gjithëve", "Midis dy njerëzve", "Pajtoni i fundit", apo dhe romani i publikuar pak vite më parë "Gjuha e gjakut". Më 20 shkurt të vitit 1991 thirret nga Presidenti Ramiz Alia që të marrë pjesë në Këshillin Presidencial. Nga viti 1991 deri në vitin 2006 ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë për Partinë Socialiste.

Me dorëheqjen nga posti i Kryetarit të Këshillit Drejtues të Radio-televizionit Publik Shqiptar, u largua nga politika aktive. Shkrimtari mbante postin e kryetarit të bordit drejtues në Qendrën Kombëtare të Kulturës.

E DIEL
10 Shkurt
2019

MILOSA

Ekskluzive

Rasti i rrallë i RAMI SAARIT, hebreu që përkthen letërsinë shqipe

(“Kur gjuha nuk është një pengesë, bota duket më e vogël”)

NGA DR. JORINA KRYEZIU

PROFIL

Rami Saari (17.9.1963–, Petah-Tikva, Izrael) është përkthyes, poet, gjuhëtar, redaktor, kritik letrar dhe ligjërues në disa universitete të botës. Autor i tetë vëllimeve poetike dhe përkthyes, prej disa gjuhëve të huaja. i shtatëdhjetë e shtatë librave në prozë e në poezi, thuajse të gjitha të shoqëruara me shënime prej tij, parathënie a pasthënie. Qysh në moshë të re tregoi talent në zotërimin e shumë gjuhëve. Sot, ai është poliglott, njohës i shtatëmbëdhjetë gjuhëve: hebraisht (gjuha amtë), finlandisht, greqisht, spanjisht, portugalisht, katalanisht, hungarisht, suedisht, estonisht, polonisht, rusisht, anglisht, arabisht, turqisht, galicianisht, maltezisht, mes të cilave edhe shqip.

Në Argentinë kaloi fëmijërinë e hershme, ndërsa kur ishte 4 vjeç u kthye sërish në vendlindje. Arsimin fillor e atë të mesëm e kreu në vendlindje, në Petah-Tikva, qytet që ndodhet në lindje të Tel Avivit. Gjatë periud-

Unë shkruaj Paqe kur shkruaj dhimbje
me zjarr dhe ajër
ngjeshur në grushtin tim
drita po rritet
Ashtu si një luftë e fortë
Brenda urisë nën lëkurën time
Ardhur nga shpatullat e mia
Dhe duhet që unë të jem
flaka e trupit tënd

PËR ÇFARË PO MENDON

Për çfarë po mendon?
Kockat e mia të vetmuara
penjët në lakuriqësinë e nëndarjes së pambukut
Për çfarë po mendon?
Mishin tim dhe bebëzat e syve të mi
këngën e endacakut të artë
në rrugët e ëndrrave të mia

Për çfarë po mendon?
Nëse nesër unë vdes, djali im
sot është e Shtunë
thirrja jote shmag hijet



Nëse nuk mendon ndonjëherë
unë do të shkoj në park
ku moshë ime
po pret për më shumë lexime

Do të shkoj
ta ndjej veten të përqafuar
nga lumi me ngazëllimet e tij
ndërsa perëndimi i diellit përgatit ujërat
të kokolepsen me disa tregime pasditeje
midis dëllinjave

Pastaj ndoshta
Unë dehem
me dritat që zbehen të bankëzat
vetmi-qeta në pikturën e tharë
me konture të figurave vjeshitore.

DUKE TË KËRKUAR TY

Oh! Jeta e trupit tim dhe forca ime, e gjitha ti,
shpirti dhe zemra, oh!
Ti je zemra dhe shpirti im! E gjitha ti je bërë me
gjithë qenien time,
prandaj ti je i gjithë unë. Unë s'kam bërë asgjë të ty,
kjo është arsyeja pse unë jam ti i gjithë.
Rumi

Përkshova shumë shekuj
me sytë e lagësht
me lotët e fëmijës
të rërës dhe erës

Unë u deha
prej dashurisë tënde të besueshme
shtypur në mua
Emri y
deri në kujtesë hyjnore

ti e di të gjithë këtë
në kohë të pakufizuar
formash të pamundura
ti i di kush je
dhe ti nuk më njeh mua

me çfarë emri duhet të të kërkoj
në këtë vend shenjash
kur unë puth largësinë
e madhe
nga lotët e mi deri në shtëpinë tënde?

humba
në thirrjet e erës
prapa perdeve
ku dridhet gjaku
dhe ne jemi vërtet
copëza të një puzzle

të ljer me butësi të egër
të njëjtë me fluturimin e zjarrit
kur të emëroj ty dhe ti më emëron mua
në boshtin shpirtëror të Universit.

FRUTA TË ARTË

Në agim të kohëve
Në botën time qiellore
M'u dorëzua një shenjë e çuditshme
në pëllëmbë të dorës
Pashë një kopsht të harlisur
Me fruta të artë
Ky është sekreti
Dhuratat që mua më mahnisin
E papritura në kërkimet e gjera

Për të gjetur njerëz me shpirt të jashtëzakonshëm
Këto kushte tani në përkasin në
në çdo horizont
ku vëllazëria është e bekuar.

MËRGIMTARI

I mençur dhe syçelët ai njeri
dihati thellë
dhe falenderoi Qiellin
Që arriti gjallë
Mimoza rrahu bregun
Njeriu puthi tokën
E tharë e të thatë

Nga larg
Indiani e pa
Mbushur ankh
Ndryshoi rrjedha e shpresave
Ajo erë e vazhdueshme, e ashpër
Shpupurisë

Deti pagëzoi rrobat e tij
Bagazhet e tij
Ushqimet
Vetminë e njëjtë
Përdredhjet e brendshme
Gjuha dhe kujtimet
Një këngë bënë në zemër

Jugu iu hap kraheve të tij
Zogjtë e përgëzonin nga foletë
Gjithë pasuria e detit dhe e brigjeve

Më vonë, kur njeriu sy-çelët
Nisi të çapisë udhët
Të mbjellë grurë, të ndërtojë kisha
vështroi indianin
gjatë dhe qetë

Indianët e donin tokën
Që punoi i huaji
Era e plasarit fytyrën e njeriut
Dhe me atë ritëm e bëri të vjetër

Përtej më matanë, guanacos, pewen
Legjenda dhe britma të indianëve gjysmë të edu-
kuar
Dhe gjaku i derdhur në pllajë!

Ishte muaji gusht kur San Jose shkoi
Pëllumbat ngatërroheshin në kullën me kambanë
Gjiri drithëronte
Biguas, flamingos
Bustardë të mëdhenj, çafka deti
Grija e kthyer e pasdites
Njeriu me sy të çelët
Këndoi himnin e tij
Lartësoi dinjitetin e tij dhe
psherëtiu së fundmi.

NJERËZIT DRIDHEN!

Njerëz që jetojnë në mungesë mbiemrash
sëmundje të shumta daffodilësh dhe narcisësh
derdhen nëpër petale
ndërsa dhëmbja
zhytet në kaq shumë lule

Njerëzit dridhen në dritë!
gjatë idusit të majit dhe shtatorit
bloqeve të mprehta, në porta
grimash dhe dashurie

Njerëzit dridhen para dobësisë!
Kur drita buis
e dëbuar nga lmbat
Njerëzit tremben në takim me shpirtin të tjerët!
poshtërim ere
marrëzi e ndizur në terr

flakë e vazhdueshme që rrjedh gjak
e mira është një dhuratë
shpejtësia është larg dhe dëshiruar

Njerëzit dridhen me shkëputje!
shikim i pastër i brendshëm
dashuri dhe marramendh
bashkuar hapat e arrirë
zemrat e njerëzve
një tokë e re pjellore
nën hije blu
në trafikun e heshtjes të fjalëve
dhe kërkimit të virtytshëm

PËRJETËSI

E lashë mungesën
Në një kristal vjollce

Lashë një karusel në qoshe
dhe shkova pas violinave,
përhapi, çimento, shputat e mia!

E lashë qiellin urban
në plasaritë dritare
me dritë lotësh
duke hyrë në dhomë
duke ngritur në një univers engjëlli
zogj dhe agime
me kacavjerje ëndre
në qiellin e një muri tjetër

E lë heshtjen tuaj
Të me harrojë mua
në djersë çatish
pas shiut

Dhe iki, ja
libri im për ju, në stacionin
ku Orient Express
trondit zemrën time sërisht dhe sërisht,
A është kjo përjetësia?
Në liri, kaq i pastër shpirti
Se mos është lojë?
Një përzierje e myshkut dhe e rubinit
me ndjesën e thjeshtë
për të mbetur gjallë

Mbase heshtjet e shumta
janë fole ledhatimesh
të të dashuarve
frymë e ngrohtë
e gjitha qëllim
Mbretëreshë nate
në trupin e ujit.

...NGA NUMRI I SHKUAR

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Shkrimi kryesor iu la një argumenti të Luan Ramës, për legjendën e Konstandinit. Në stilin e tij të zakonshëm publicistik, duhet të themi se shkrimi është realizuar shumë qartë dhe ishte tejet atraktiv. "Duke punuar për librin e studiuesit francez dhe konsull në Janinë, (1869-1875) m'u desh të studioja dhe versione të tjera të ngjashme ballkanike si dhe krijimin e poetit gjerman Gottfried August Bürger, Le-onore. Madje, për shumë kohë, kjo legjendë mbahej si një krijim popullor gjermanik...duke hyrë në botën e vet legjendës, kupton se ashtu si dhe në përrallat e vjetra, ato kanë shteguar nga një popull në tjetrin, brenda sferës ballkanike, si kultura të përafërta, edhe pse origjinale, duke marrë nga krijimet e njëri-tjetrit. Megjithatë, një gjë duket e sigurt: kjo legjendë, ka si atdhe jo Perëndimin e as Lindjen e Largët apo të Afërt. Ajo ka si atdhe veçse Ballkanin!..."Pak e lodhshme të fusësh Ballkanin kudo, por e respektojmë idenë e tij.

Botuam një cikël poetik të Sokrat Paskalit, ardhur shumë kohë më parë, që shquhet për mënyrën sesi e trajton poezinë dhe një figuracion të kënaqshëm. Redaktori shtoi diçka për ekspozitën e fundit të Maks Velos, realizuar te FAB, "Fshati primitiv ndriçohet nga meteorë"

dhe shkroi se Maksit i buron natyrshëm drita dhe ajo përcillet ngado tashmë në telajon e vet. Abstragimi, ngjyrat dhe fantazia miksohen për të sjellë botën primitive në kohën tonë, por edhe përcillet një lloj ndriçimi i spikatur që është bërë i natyrshëm në krijimtarinë e fundit të këtij autori punëtor. Si në një karusel gjigand, personazhet përzihen me subjektet dhe na japin një botë që lulëzon prej vitesh në shpirtin e piktorit tonë, pjesë e përshfaqjes së ideve artistike, gjeneruesit të debeteve dhe jo vetëm...Redaktori beson se Maks do të shprehë pakënaqësitë e tij për shkrimin, por mbi të gjitha dhe largimin e redaktorit prej pak kohësh nga jeta kulturore.


Vetë redaktori shtoi një përkthim të një interviste të vjetër të Tomas Elliot, ku ai shprehet se: "Ar-rita të bëhem shumë prodhues nën influencën fillimisht të Bodlerit dhe pastaj të Jules Laforgue, të cilin e kam zbuluar menjëherë në vitet e rinisë sime në Harvard"...

Ndërkohë që në këtë numër erdhi dhe një shkrim i hershëm prej Viktor Koliqit, i titulluar Kur bie shi në Shkodër me sugjerimin e një mikut të tij, ndërsa plotësoi dhe kritikën e kolegut Çapaliku për një kopertinë të munguar libri (në fakt e vendosur gabim), duke e botuar te Mea Culpa...Mund të themi se ishte numër relativisht i paqhtë dhe i mirë, por mund të ishte shumë më i qartë po të ishte më i mbledhur.



Referuar specialistëve, Amfiteatri i Durrësit është gërmuar deri 80%, ndërsa ka mbetur i pagërmuar dhe 20% i tij, vëllim, që mendohet se do të nxjerrë në dritë me shumë gjasa dhe plot gjëra të tjera të pagjetura deri më sot. Fatkeqësisht, prej vitit 1990, kohë kur Shqipëria mori një drejtim tjetër, ekspeditat kanë munguar dhe ç'është më e keqja duket se edhe punët që janë bërë në amfiteatër kanë qenë sporadike...

A do mund të zbulohet ndonjëherë krejtësisht Amfiteatri i Durrësit?!



NGA BEN ANDONI

Nëse do të shikosh sesa vlerë kanë pasur për të gjitha qeveritë shqiptare projektet arkeologjike, atëherë mund të marrësh si kampion vëzhgues, Amfiteatrin e Durrësit. Vepra e madhe e inxhinierisë, datuar dy shekuj pas Krishtit, është një nga më të rëndësishmet e kohëve antike për të gjithë arenat e Mesdheut. Për Durrësin, që në momentin kur është zbuluar në vitin 1966 prej arkeologut Vangjel Toçe, mbetet objekti më i rëndësishëm arkeologjik, ashtu si edhe për të gjithë vendin tonë dhe mbase i jashtëzakonshëm edhe për vetë trashëgiminë e Gadishullit Ballkanik.

Referuar specialistëve është gërmuar deri 80%, ndërsa ka mbetur i pagërmuar dhe 20% i tij, vëllim, që mendohet se do të nxjerrë në dritë me shumë gjasa dhe plot gjëra të tjera të pagjetura deri më sot. Fatkeqësisht, prej vitit 1990, kohë kur Shqipëria mori një drejtim tjetër sa i përket sistemit ekonomik-shoqëror, ekspeditat kanë munguar dhe ç'është më e keqja duket se edhe punët që janë bërë në amfiteatër kanë qenë sporadike.

Pak kohë më parë, Ministria e Kulturës e tregoi si sukses heqjen e pak shtëpije nga objekti, por duhet thënë se ende sot e kësaj dite nuk ka asnjë impakt të këtij vendimi. Pak më të vështirë të gjithë procesin e bënë edhe autoritetet, që kanë lidhjen me arkeologjinë. Që do të thotë kërkimi shkencor varet nga Min-

istria e Arsimit dhe Shkencës, kurse veprimtaria konservuese varet nga Ministria e Kulturës. Është e vërtetë se nëse do të konfuzosh punë, duhet të krijosh institucione dhe ndërvarësi dhe një gjë e tillë ndodh pak a shumë edhe në Shqipëri me rastin e Amfiteatrit. Krijimi i shumë instancave, sidomos me këtë që po ndodh me arkeologjinë tonë, që është e hapur ndaj grabitjeve, keqbërësve por edhe e shumë gjërave të tjera, ka bërë që të mendohet se nuk ka shumë mendim të përqendruar për pasuritë tona

Amfiteatri e Durrësit, çfarë mund të ishte

Saari është konsideruar ndër përkthyesit më produktivë në hebraisht, laureuar me Amfiteatri i Durrësit ka fatin se është afër kryeqytetit, por është dhe i vendosur në një qytet që mbushet me turistë. Duket se veç instancave dhe vetë Bashkia e qytetit nuk ka ndonjë interesim për të, pasi me vite ka kontribuar në këtë kaos i cili lidhet me këtë objekt.

Amfiteatri duket si një objekt i përfunduar për shumicën e shqiptarëve, ndërkohë që objekti i cili u ndërtua në kohën e sundimit të perandorit Trajan, mund të impononte zhvillimin turistik të qytetit dhe më shumë akoma të bëhej objekti, ku mund të vërenim realisht zhvillimin tonë

arkeologjike. Dhe, është për të ardhur keq, se administrimi si duhet i Butrintit bëri që njerëzit e kulturës por sidomos të turizmit të kuptojnë se mund të fitosh pastër dhe bindshëm edhe nga arkeologjia. E madje, jo pak. Përvoja botërore dhe mënyra sesi i menaxhojnë pasuritë arkeologjike fqinjët tanë, ka treguar se po të dish dhe të menaxhosh kulturalisht atëherë mund të krijosh jo thjesht vlera por edhe më shumë.

Amfiteatri i Durrësit ka fatin se është afër kryeqytetit, por është dhe i vendosur në një qytet që mbushet me turistë. Duket se veç instancave dhe vetë Bashkia e qytetit

nuk ka ndonjë interesim për të, pasi me vite ka kontribuar në këtë kaos i cili lidhet me këtë objekt.

Amfiteatri duket si një objekt i përfunduar për shumicën e shqiptarëve, ndërkohë që objekti i cili u ndërtua në kohën e sundimit të perandorit Trajan, mund të impononte zhvillimin turistik të qytetit dhe më shumë akoma të bëhej objekti, ku mund të vërenim realisht zhvillimin tonë.

Kjo ka pak gjasa të ndodhë sepse fatkeqësisht nuk kuptohet vlera e këtij objekti, që na jep kaq qytetari në arkeologji dhe mund të ndikonte që Durrësi në planet tona mund të bëhej kryeqyteti turistik i vendit. Kuptohet se kjo nuk ka ndodhur, sepse arkitektura antike e këtij qyteti është dëmtuar, kurse njerëzit e arkeologjisë shqiptare nuk mund të bëheshin dot zëdhënës të punës së tyre dhe mbrojtës të trashëgimisë së madhe të shqiptarëve. Më shumë akoma, me katrahurën që është bërë tek ne, zor të besosh se ndonjëherë do të zbulohen krejtësisht konturet e kësaj veprë mahnitëse inxhinierike, që fati e ndërtoi ndër troje tona. Dhe, fjalët më cinike nuk mjaftojnë për ngushëllim pasi kur lirim i tij s'u bë gjatë kohës së diktaturës, ka shumë pak gjasa të vlerësohet ndonjëherë, se ai do të zbulohet ndonjëherë...qoftë për të mirën e vetë objektit, por edhe për të mirën e turizmit shqiptar.

(Milosao)

Opinion *i* Ditës

A po e lodh opozita me protestat, qeverisjen Rama?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

... që i janë dedikuar këtij aksioni, ndërkohë që Pozita me mjetet jo të pakta në dispozicion, nga ana tjetër, po mundohet ta relativizojë sa të mundet situatën, sikur të jetë normalitet. Që do të thotë se ajo e paraqet si një aksion fare të zakonshëm në vendet demokratike. Media e tendosur mes këtyre qëndrimeve, mezi pret ndonjë rast të skajshëm kinse për t'u larguar. Dhe, ndodhi që njësoj si rasti i fundit i Kavajës, të shkëpusë pak vëmendjen, por sërish publikut iu servir prej saj, ajo që ka më shumë nevojë: politika. Duke mos pasur vëzhgime të kujdesshme dhe anketime ka disa skenarë hamendësimi, por e vërteta është një dhe vetëm një: Neve nuk jetojmë dot pa politikë dhe nga të gjithë pasojat e saj.

Së fundi, opozita ka bërë disa thirrje ekstreme përmes liderit të saj, Lulzim Basha, duke i kërkuar kryeministrit të vendit të japë dorëheqje, para 16 shkurtit (kohë e precizuar për një protestë), pasi pastaj do jenë ata që do vendosin. E thënë në këtë mënyrë, lë shteg për shumë interpretime. Dhunë? Demonstrim? Skenari i huaj, që nuk ka mundur të fitojë në Rumani, nuk duket shumë i përshtatshëm për Shqipërinë. Protestat në vend, paçka dorës në dukje të opozitës që nuk është vështirë të kuptohet, kanë në thelb pakënaqësinë e madhe të njerëzve. Që përveç kritikave të natyrshme për kryeministrin e vendit si rezultat i arrogancës dhe rregullave të munguara të lojës prej tij, mbartin pakënaqësinë me gjithçka që është arritur, shtuar edhe mungesës së funksionalizimit të duhur të shtetit. Veçse retorika e ndarë dysh e opozitës për fizionominë e protestave, po luan rol jo të mirë në publik.

A do mundet aksioni politik të mbështetet edhe pas 16 shkurtit? Kjo është dilema e pazgjidhshme, duke parë deri më tani si funksion PD dhe LSI. Për kundërshtarët e Bashës jemi afër një pakti të ri në interes të ngushtë të tij, për të tjerët ku zëri më i spikatur është ai i Berishës, kemi nevojë për skenarin venezuelian, ku protesta nuk duhet të ndalojë. Por a ka paralele dhe realitete?! Dukshëm jo, pasi Venezuela veç problemeve të mëdha të brendshme është një faktor në skakierën gjeostrategjike për shkak të pasurive natyrore, kurse Shqipëria me gjithë dëshirën e faktorizimit tonë nuk e ka këtë rol. Dhe, më shumë se kaq: Shqipëria pret hapjen e negociatave, por duket se tashmë askush nuk mund të besojë që ato



mund të hapen me këtë nivel demokracie në vend dhe parimet kudo të përkeqësuar. Çu-

ditërisht, në vend që kjo të dhembë, ajo përjetohej gati si kënaqësi nga opozita, duke na

A do mundet aksioni politik të mbështetet edhe pas 16 shkurtit? Kjo është dilema e pazgjidhshme, duke parë deri më tani si funksion PD dhe LSI. Për kundërshtarët e Bashës jemi afër një pakti të ri në interes të ngushtë të tij, për të tjerët ku zëri më i spikatur është ai i Berishës, kemi nevojë për skenarin venezuelian, ku protesta nuk duhet të ndalojë. Por a ka paralele dhe realitete?! Dukshëm jo, pasi Venezuela veç problemeve të mëdha të brendshme është një faktor në skakierën gjeostrategjike për shkak të pasurive natyrore, kurse Shqipëria me gjithë dëshirën e faktorizimit tonë nuk e ka këtë rol.

bërë një vend hipokrit sa i përket qasjeve integrale. Megjithatë, parashikimi për mos hapjen e tyre dhe shfrytëzimi me kujdes i protestave kudo (kuptohet që një pjesë ka vetë opozitën pas), ka bërë që Pozita të lodhet dukshëm (kjo kuptohet nga gabimet e mëdha dhe sjelljet e zyrtarëve të saj), ndërsa i gjithë publiku të merrizitet me këtë gjendje tranzicioni që nuk merr fund. Cfarëdo që të jetë e ardhmja e protestës dhe pas 16 shkurtit, Shqipëria dhe për disa vjet do të vuajë udhën e vet dhe rrugën e vështirë për krijimin e identitetit demokratik. Ndaj, qeveria Rama nuk është aq shumë e lodhur, sesa e paafte për të përshfaqur forcën e saj në këtë kaos, që e ka krijuar vetë me drejtimin tejet të dobët në mandatin e dytë të saj.

HOROSKOPI

DASHI

Dita e diel për këtë shenjë do të sjellë përjetime e situata të pakëndshme. Ju mund të bëni sjellje të pazakonta për t'i rënë në sy një personi që ju pëlqen. Gjysma e dytë e ditës ka të ngjarë të përbëhet nga udhëtime dhe takime jashtë shtëpisë tuaj.

DEMI

Për të lindurit në këtë shenjë dita e sotme nuk rekomandohet për të bërë blerje të shtrenjta. Ju mund të ndihmoni një mik të ngushtë për të gjetur një zgjidhje për një problem të tij personal.

BINJAKET

Nëse dëshironi mund ta ktheni këtë të diel në një ditë feste. Duhet vetëm dëshira e mirë, sepse do të rrethoheni nga pozitiviteti dhe dashuria nga miqtë e ngushtë dhe familja. Megjithatë, mund të ndodhë që në një moment të keni nevojë për privatësi.

GAFORJA

Gaforret sot mund të gjejnë një hob të ri. E diela nuk ka gjasat tju shkaktojë ankth. Megjithatë, nuk rekomandohet të bëni blerje të pa-nevojshme apo të filloni një projekt biznesi të ri. Ekziston reziçu që çdo transakcion financiar të çojë në ulje të të ardhurave tuaja.

LUANI

Gjatë kësaj të diele mund të përballeni me disa mosmarrëveshje ose të pësoni një zhgënjim. Gjithashtu, do të dëshironi të surprizoni miqtë tuaj të ngushtë me dhuratat të vogla. Ka gjasat të nisni një lidhje të re romantike.

VIRGJERESHA

Duhet të tregoheni të kujdesshëm kur komunikoni me të afërmit tuaj, pasi mund të ofendohen. Gjithkush ka të drejtën e mendimit të tij personal. Në mbrëmje mund të merrni disa lajme të papritura. Për fat të keq, ky lajm mund të jetë zhgënjës.

PESHORJA

Peshoret mund të kalojnë një ditë të qetë, por një situatë e vogël e pakëndshme nuk përjashtohet. Mos rritni të jeni kudo. Mos jepni premtime që nuk mund t'i mbani. Mos kërkon shume nga vetja ose mos kërkoni mangësinë e sjelljen e partnerit tuaj.

AKREPI

Të lindurit e kësaj shenje do ta kalojnë ditën duke i dhënë makinës. Familja do të ketë shumë nevojë për ndihmën tuaj. Megjithatë do të kaloni një mbrëmje krejtësisht ndryshe nga të tjerat, ku nuk do të mungojnë surprizat dhe miqësia e ngrohtë.

SHIGJETARI

Është dita e duhur për të kaluar sa më shumë kohë me fëmijët. Duke u aktivizuar në lojërat e tyre do tju ndikojë mjaft mirë edhe ju fizikisht. Në mbrëmje ka gjasat të takoni dikë me të cilin do të zhviloni një bisedë shumë të rëndësishme për karrierën tuaj.

BRICJAPI

Idetë e reja nuk janë gjithmonë ide të mira. Mos e pranoi pa mend një teori të veçantë të re që një person po përpiqet t'ju imponojë. Sigurohuni që ideja të jetë e shëndoshë para se ta pranoi atë.

UJORI

Ujorët do të zgjidhin një problemin, me të cilin kanë kohë që përballen. Mund të shyeni një borxh që ka kohë që ju mundon. Sa i përket lidhjes suaj romantike, gjithçka do të shkojë si normalisht.

PESHQIT

Peshqit rekomandohen t'ia kalojnë këtë ditë relaksit. Shija në ajër të pastër mund të jetë zgjidhja e duhur për ju. Gjithashtu do të argëtoheni nën praninë e miqve tuaj më të ngushtë. Ka mundësi që disa prej tyre të kenë nevojë për ndihmën ose këshillën tuaj.

Opinion i Ditës

Doktor Jani Basho, Fator i këtij vendi...

Nga PANO HALLKO

(vijon nga faqja 1)

... në shërbim të tij. Këta njerëz, rilindësit tanë i quanin Fatorë të kombit, d.m.th. fatsjellës të tij. I quanin kështu rilindësit, pa qenë të ndërgjegjshëm se vetë ata, ishin ndër të parët Fatorë të këtij vendi...

Njëri ndër këta të paktët Fatorë të këtij vendi, ishte dhe mbeti Dr. Jani Basho...

...Profesori i mirënjohur e njëri nga personalitetet më të spikaturat të mjekësisë së sotme shqiptare Jovan Basho, i cili përgatiti librin për Dr. Jani Bashon, si... "Detyrim kombëtar, profesional, por edhe si detyrim për emrin që më kanë vënë paraardhësit e mi", në faqen e fundit, shtron pyetjen, e përgjigjen e kërkon nga lexuesit: - "Personalitet ka qenë ky burrë?..."

Për ata që kanë lexuar librin, nuk ka pyetje më të sinqertë. Sepse edhe ata-lexuesit-të çfarëdo niveli e intelekti qofshin, me të njëjtën pyetje në buzë ngelen kur përfundojnë leximin.

Dr. Jani Bashon e ngjizën geni dhe trolli. E natyra, e pajosi në mënyrën më të përsosur të saj. Por fati e sulmoi qysh kur ishte fëmijë. Tetë vjeç, "fati" e sollë që ai të përjetonte vrasjen e të atit në mullirin ku punonte në Selocën e Poshtëme, për të mbajtur familjen që kishte në Pogradec. E vrau beu i Starovës, i cili si të gjithë bejlerët "shqiptarë", kur nuk arrinin të merrnin pasuritë të cilave u kishin vënë syrin, i vrisnin të zotët e tyre.

Vëllai i madh i Dr. Bashos, Gjoka, ngriti padi kundër vrasësit, por në Shqipëri bejlerët e kishin, pushtetin dhe gjykatën. Qysh atëherë...

Dora e gjatë e turkoshakut të Starovës, arriti edhe deri në Manastir të godiste Jani Bashon, duke e akuzuar si "spion" të grekëve. U arrestua nga serbët, e u dënua me vdekje. Por për fatin e tij dhe të këtij vendi, dibranët atë natë-natën e fundit të jetës së tij sipas vendimit të gjykatës serbe, i thyen serbët, e kështu shpëtoi Jani 21 vjeçar.

LISAT DHE FILIZI...

Për fatin tonë të mirë, Jani Basho takoi Gjergj Pekmezin, e i cili e bindi të shkonte në Austri dhe të studionte për mjekësi.

Fati i tij, por edhe i yni e sollë që, në ditët e para të qëndrimit në Vjenë, të takonte Faik Konicën e madh, i cili pasi i bëri një "dush" me kritika "alla Faikçe", e mori në provim në mënyrën e tij.

Ai arriti të mbrojë Diplomën në Mjekësi, me titullin e veçantë "Unicus Medicus Doctor", i cili jepej shumë rrallë edhe për vendasit që shkëlqenin, pa lere më për të huajt.

"Djalëria shqiptare e sotme nuk është në gjendjen e ëndshme të asaj



të kombeve të tjerë, e nuk ka trashëguar prej të parëve të saj bashkimin e kombit të vet, e as lirinë e tokave shqiptare", do të shkruante Doktori i famshëm në faqet e Revistës "Dialëria", kryeredaktor i së cilës jo rastësisht ishte.

Mjeku i ri, i pajisur me Diplomën e veçantë mbrojtur me "Medalje e Artë", pas specializimeve për Kirurgji dhe Obstetrikë, arriti të shpallet në Spitalin Universitar të Vjenës, zëvendësi i parë i kryekirurgut të Vjenës, profesorit Denk.

Aq i artë ishte Doktor Jani, sa që fitoi simpatinë e një profesori të madh, i cili i shprehu dëshirën këtij të vinte në Korçë për të punuar si mjek e për të bërë studime. Por përgjigja e "shtetit shqiptar", ishte... "kemi mjekët vendas, e nuk na duhen të huajt".

I zhgënjyer profesori austriak, i thotë Janit tonë: "Eja me mua, se po shkoj të hap Fakultetin e Mjekësisë në Buenos Aires. Ti ke të ardhme, e atje ekonomikisht do bëhesh njeri".

Amerikanët i kërkuar, gjithashtu, të drejtonte Fondacionin "Rokfeler" në Amerikë. Por ai nuk pranoi...

Historia nuk është rastësi, e njerëzit gjithashtu. Jani Basho ishte patriot, me tërë genien e tij, me tërë prejardhjen e tij.

Por duke qenë Kryetar i Shoqatës "Dialëria" e kryeredaktor i revistës së saj, Jani Basho pati fatin të bashkëpunonte me Bajram Currin, Rexhep Prishtinën, Faik Konicën, Haxhep Mitrovicën, Gjergj Pekmezin, por edhe me personalitetet të shtetit austriak si T. Ippen, E. Nopça, Oberhumer, etj. Ishte ai që organizonte mbledhjet tematike për nder të Aleksandër Moisiut, Mis Durhamit, Ainshtajnit etj.

Se punonte me këta personalitete, prandaj shkruante në revistë: "Popujt fqinj tanë, në të njëjtat kushte me ne, por të ndihmuar prej fatit e të prej të tjerëve, na shkelen dhe këputen prej trupit të gjallë të kombit tonë pjesë, të cilat i mbajnë edhe sot nën thonjtë

e tyre. Ashtu siç organizmi nuk mund të rrojë pa disa organe të domosdoshme, ashtu edhe kombi, nuk mund të rrojë pa tokat që i kanë rrembyer". Kur ishte student, ai shkruante: "Gjuha Shqipe është gjaku i trupit shqiptar dhe dielli i kopshtit kombëtar". E të mendosh se ky njeri, asnjë ditë nuk u shkollua në gjuhën shqipe!

Grekët dhe serbët e quanin Shqipërinë "Turqi e Vogël". Ndaj Jani Basho shkruante në revistë: "Kur t'i vijë ora e vdekjes "Turqisë së Vogël", edhe ortodoksët shqiptarë do të dinë të vdesin meritisht me vëllezërit e tyre shqiptarë të tjerë". Sepse punonte me ata patriotët të mëdhenj, ai e kalonte në radhën e dytë fenë dhe besimin fetar. Dhe shkruante: "Ortodoksizmi? Ky ka për ne, para shqiptarizmit, vlefëtin e një petke, që nuk i ka hije aq tepër mbartësit, edhe që mund të shkundojë prej trupit tonë në çdo rast". ("Dialëria" Vieti II, nr. 13, fq. 12-14, 1921).

NDËRTOI TRE SPITALE, POR...

"Parlamenti duhet të mbledhë aristokracinë e mendjes, intelektualët e vërtetë të kombit; njerëz të ditur e të ndershëm të cilët, pa u munduar shumë për të mirën personale, kanë vendosur të realizojnë idealin e shenjtë të popullit".

Qysh kur Jani Basho ishte 28 vjeç, ... "parlamenti duhet të mbledhë"...

Qysh kur Doktor Jani ishte 30 vjeç, ... "Universiteti është një republikë e përbërë prej profesorësh dhe studentësh... Themeli mbi të cilin Universiteti qëndron e për të cilin bie, është liria e plotë për ata që japin mësim, edhe për ata që marrin mësim. Në lirinë akademike, profesorët dhe studentët janë një. Ky është flamuri nën të cilin mblidhen shtetasit akademikë, edhe nën hijen e të cilit, mosmarrëveshjet pushojnë. Se dituria do liri, që të mbetet e re"... ("Dialëria", nr. 1 viti 1920). A thua se Doktor Bashua, ishte në protestën e dhjetorit të kaluar, duke shpërndarë "pedagogët" pazarrxhinj të Tiranës...

Për herë të parë Zogun e takoi

në Vjenë, në vitin 1918. Dr. Jani, ishte në kafe me Faik Konicën. Zogu hyri, e pa përshëndetur, pyeti Faikun e madh: "A vetëm qenke këtu, o Faik bej? Djallëzia fshatarake dhe sejmënlëku i lindur; të vetmet "cilësi intelektuale" që kishte, e shtynin të injoronte një djalë të ri, me të cilin Konicë po pinte kafe. Por Faiku i madh, që nuk bënte kompromis as me vetë djalë, "ia bubulloi" Zogut: "Jo që nuk jam vetëm, por jam me më të mirin student të Shqipërisë këtu, i cili vazhdon për mjekësi. Eja të ta paraqes!" Zogu u ul "për nder të armëve", e pas pak minutash u largua me bisht ndër shalë...

...ASNJË SPITAL NUK MBAN EMRIN E TIJ!!!

U takua me Zogun, edhe kur ai ishte president e mbret, e kishte një abses në fund të zorrës së trashë. I firmosi diagnozën (paraproctitis), e i tha se do ta operonte. Por... Ceno Kryeziu, nuk kishte besim!!! Cenua, me djallëzinë fshatarake dhe sejmënlëkun e lindur që e karakterizoi zotni-ashtu si punëdhënësin e tij, i tha: "Ma shkruaj diagnozën në një copë letër". Me letër në xhep, e me makinën e shtetit, iku Cenua në... Cetinë! Shkoi tek aleati i vjetër, tek ai që i sollë në zyrat e Tiranës, për të shitur dhe shtypur Shqipërinë. Nga Cetina sollë një profesor bjellorus, nga njerëzit e ngushtë të Vrangelit, bashkë me një mjek malazez.

Vrangelisti u shpërblye me 500 napolona flori, kurse malazezi me 150. E përse? Për një fistul! Kur po e merrte Doktor Jani (se Vrangelisti mori paratë dhe iku), i shfaqti idenë e ndërtimit të spitaleve. Dr. Jani, do të ikte në Vjenë, e i tha Zogut se ai mund të kthehej, vetëm nëse në Tiranë ndërtoheshin spitalë për popullin, ku ai mund të punonte.

"Nuk kam menduar të bëj spitalë tani. Por po erdhe ti nga Vjena, flasin.

Doktori i madh shkoi në Vjenë, e falë personalitetit të tij, arriti të marrë (e jo të blejë), projektet e gatshme për ndërtimin e spitaleve në Shqipëri.

Ne sot themi Spitali Ushtarak (ai që patëm), Spitali 1, Spitali 2... Ose themi Materniteti i Vjetër... Por njerëz shumë të paktë, njohin faktin që themeluesi, frymëzuesi, luftëtar i vetëm për ndërtimin e tyre, ishte vetëm një njeri i pa zakonit: Dr. Jani Basho.

Banorët e sotëm të këtij vendi, mendojnë se këto spitale që kanë sot, ose "rastësisht janë aty", ose... "aty kanë qenë, qysh në krye të herës!"

Shumë pak njerëz sot, mund të dinë faktin se themeluesi i Mjekësisë moderne shqiptare, arkitekti, edhe në kuptimin e mirëfillt të fjalës spitaleve tona, është personaliteti i shquar i mjekësisë shqiptare me famë botërore, Dr. Jani Basho.

Shumë pak njerëz dinë sot, se në vitet '30 të shekullit të kaluar, spitali nuk njihjej as si fjalë në Tiranë. Më saktë të themi, Hani që ka qenë

te Sahati i Tiranës, ishte "përshtatur" edhe si... "spital"!

Doktor Jani, ia sollë shtetit projektet e spitaleve nga Vjena. Falas.

E "shteti", qysh atëherë, bëri tenderët... Qysh atëherë, u vodh në mënyrë të paskrupullit. Edhe atëherë, "shteti" e kishte shpallur me ligj korrupsionin, qysh kur emëroi Hajri Hajrullahun drejtor të doganave.

Doktori i madh, i shikonte të gjitha. E kjo ishte arsyeja, që ai nuk vuri firmën aty ku ishte shkruar emri i tij, si marrëzim në dorëzim i spitaleve.

Edhe sot e kësaj dite, ai dokument në arkiv, nuk ka firmë poshtë emrit Jani Basho.

Ai themeloi me plot kuptimin e fjalës, Maternitetin e Vjetër të Tiranës. Jo thjesht se ishte për disa vite, deri në 1952, drejtori i atij Materniteti. Por sepse mbi Dr. Janin, nuk pati mjek Obstetër ky vend.

Gjithë sa shkruhen më lart, nuk janë vlerësime të shkruarit të këtyre radhëve. Ato u thanë në mënyrë të përmbledhur, në datën 12. 02. 1957, nga përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Zisa Cikuli, në Fjalën e përcjelljes së Doktor Jani Bashos: "Bir i një fshatari të varfër, ti ke qenë i vetmi që je munduar gjatë regjimeve antipopullore, për ngritjen e spitaleve dhe përgatitjen e kadrove mjekësore"...

Kurse dr. Koço Glliozheni (emrin e të cilit mban materniteti i ri), e përfundoi lamtumirën e tij për Doktorin e madh, me fjalët: "Si do bëjmë pa ty?... Pas çdo konsulte mjekësore, mendimi yt ka qenë gjithnjë fjala e fundit!"

Ka pasur dikur ca burra ky vend, që e thoshin aqçit meritën e tjetrit. E keja jonë është se ata burra, u zhdukën, pothuaj me gjithëse...


E Lasgushi, me mënyrën e tij, Homazhin ia bëri me vargje: "Mes atdheut të Shqipërisë/Cave rrugë mundimplotë/Puthi ballin e lavdisë/Mendja jote e shkenca jote. Tani fle, shpirt i pa vdekur/ Në selinë e së vërtetës/Lundërta që s'u pat prekur/Prej tilla zezave të jetës!..."

Ironia e fatit tonë (e jo e fatit të Atij), është se ndërsa Doktor Basho ndërtoi tre spitale dhe i themeloi me mjekë të cilët vetë ai i përgatiti dhe i udhëhoqi shkencërisht, i drejtoi ndër vite dhe ia frymëz e fundit në punë, asnjë spital në Tiranë nuk mban emrin e tij. Për "të mos ia ngrënë hakun shoqërisë sonë", është vetëm një sallë lekcionesh (!) bërëta maternitetit të vjetër, që mban emrin e korifeut të mjekësisë sonë!! Nga dy profesorë ditnjarë të Maternitetit të vjetër, mëson se dikur, për vite, nuk po i vihej emri spitalit, pasi pritej të vdiste një doktor tjetër, e të pagëzohej me atë emër. Pastaj, po këta të thonë se... Një drejtor partiak i kishte detyrimin njërit "atje lart", i cili i bëri qokë "familjes mbretërore", e... i vunë emrin që ka!!!!... Se drejtori, mund të bëhej edhe deputet, apo kryetar bashkie... Qoka shqiptarësh domethënë! Po mirë ajo "diktatura e poshtëre", se nuk vinte emura, po kjo, "demokracia meritokratike", çfarë bën?? As Spitali nr. 2 nuk e meriton atë emër? Bëri kaq shumë për këtë vend, e mori vetëm rrogën, e... gjashtë muaj pension.

Njësh turp shumë planesh ëshëherazi; qytetar, njerëzor, profesional, por edhe shtetëror. Vjena jo që nuk ia ka fshirë emrin Fatorit tonë, por gërmat e arta të emrit Jani Basho, i pastron rregullisht, përditë. Vjena kërkohet me të, me birin tonë të madh, sepse respekton veten. Austria i di bëmë tona, por thjesht na buzëqesh, me ironi vjenëzësh, e na mbështet për në... "Europë"!!!

Por, sido që të thonë... Njëri ndër të paktët Fatorë të këtij vendi, ishte dhe mbeti Dr. Jani Basho...

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Janë ilogari.
- Kufizojnë një trup.
- Janë nocionet e para.
- Janë vendet si Katari.
- Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
- Një pije... dardhe.
- Janë me marka në armatura.
- Artikull spanjoll.
- Një pjesë e sadistëve.
- Janë shemra.
- Mund të jenë informacioni.
- Fillojnë javën.
- Janë gratë në Marrakesh.
- Një Ardian guvernator i Bankës.
- Demek s'ka kufij.
- Janë centralët si Chernobyl.
- Mbyllin një dyqan.
- Një impiant hi-fi.
- Rolet pa re.
- Një pjesë e parlamentit.

- Kufizojnë një send.
- De Filippi e Amici.
- Pagëzoi Shën Palin.
- Ushtrohet një me tryzni.
- Victorien dramaturg.
- Është edhe ai i Zi.
- Fillojnë tatëpjetën.

VERTIKAL

- Hunt aktore.
- Nolde piktor.
- Gjysmw siklet.
- Marsi në Areopag.
- Janë antena satelitore.
- Rihet në fund.
- Pak tebaizëm.
- Janë taksat.
- Një test.
- Ferrara regjisor.
- Është luftë.
- Kufizojnë citatet.
- Një lëndë e organizmit.
- Qureshin edhe Eumenide.
- Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
- Është si baba.
- Julia i Familja Addmas.
- Jules shkrimtar.
- Mafia pa zë.
- Role pa zë.
- Është zbulim në skenë.
- Irene aktore.
- Inicialet e Morricones.
- Kufij në Oslo.
- George shkrimtare.
- U shkrua nga Emile Zola.
- U shit për një pjatë thjerza.
- Film shqiptar.
- Me të nxjerrin trarë.
- Bega komik.
- Është yll i skuadrës.
- Fillojnë ndeshjen.
- Satelit i Uranit.
- Inicialet e Dukas kompozitor.
- Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Ndan kapitujt.
- Emri i Gonçarov.
- Është e hollë dhe therëse.
- Inicialet e Stone regjisor.
- Është edhe ajo mistral.
- Kryeqyteti i Marokut.
- Ki Moon në OKB.
- Është lloj papagalli.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Gjysmë tandem.
- Hapet me trapano.
- Një sigël mauesh.
- Është djali i Odiseut.
- Është sherr në shtyp.
- Artikull spanjoll.
- Është zog i verdhë.
- Mund të jetë kuzhine.
- Inicialet e Lattuada regjisor.
- Është shtet i papës.
- Mbeten në fund.
- Pesci aktor.

VERTIKAL


- Një bukanier.
- Mosketieri jezuit.
- Janë zënë në lustë të tillë.
- Pak analogji.
- Gishti pa shi
- Në radhë të parë.
- Triac që qe tenist.
- Tregohet nga busulla.
- Kacaturian kompozitor.
- Fillojnë natën.
- Vallëzon me tutu.
- Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
- Mund të jenë kursimi.
- Janë katër në violinë.
- Janë vendet e pazëna.
- Në mes të Edgar dhe Poe.
- Janë ato që na përkasin.
- Këngëtare italiane.
- Një pjesë e pavjorinit.
- Braktisi Didonën.
- Munë të jenë lubrificantë.
- Lumë në Francë.
- Kush është... do të pije.
- Nolde piktor.
- Parashtesë zvogëluese.
- Zanore arabe.
- Rastet pa set.
- Pak dramatike.
- Maket pa kufij.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Inicialet e Moravia-s.
- Është ai që premtonte të bëhet as.
- Leblanc që krijoi Arsene Lupin.
- Është ai që premtonte të bëhet as.
- Leblanc që krijoi Arsene Lupin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 9 | | 8 | | | 5 | | | |
| 3 | | | 5 | 1 | 9 | | | | 6 |
| 6 | 2 | | 4 | | | | | 8 | 9 |
| | | 1 | | | | 8 | | 9 | |
| 7 | 4 | | | | | | 3 | 1 | |
| | 5 | | 3 | | | 2 | | | |
| 5 | 6 | | | | | 2 | 7 | 4 | |
| 4 | | | 9 | 7 | 3 | | | | 8 |
| | | 3 | | | | 4 | | 1 | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| 1 | 2 | 9 | 3 | 7 | 5 | 4 | 8 | 6 | |
| 3 | 4 | 5 | 8 | 1 | 6 | 9 | 2 | 7 | |
| 7 | 6 | 8 | 9 | 2 | 4 | 1 | 3 | 5 | |
| 2 | 8 | 3 | 5 | 9 | 7 | 6 | 1 | 4 | |
| 9 | 5 | 6 | 1 | 4 | 3 | 2 | 7 | 8 | |
| 4 | 1 | 7 | 2 | 6 | 8 | 3 | 5 | 9 | |
| 5 | 7 | 1 | 4 | 3 | 9 | 8 | 6 | 2 | |
| 6 | 9 | 2 | 7 | 8 | 1 | 5 | 4 | 3 | |
| 8 | 3 | 4 | 6 | 5 | 2 | 7 | 9 | 1 | |

Argëtim filozofik

- Kënaqu me atë që ke, dhe lëri gjërat ashtu siç janë. Kur të kuptosh që s'mungon asgjë, e gjithë bota do të përkasë (Lao Tzu)
- Sa më shumë e mendoj aq më shumë e kuptoj që s'ka asgjë më artistike se sa të duash të tjerët (Vincent Van Gogh)
- A nuk është interesante se si jemi të gjithë të krijuar nga Zoti, dhe prapë dallojmë kaq shumë. (Desmond Tutu)
- Integriteti nuk ka nevojë për rregulla (Albert Camus)
- Ajo që dimë është një pikë, ajo që nuk dimë është oqean (Isaac Newton)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | 3 | | 1 | 6 | 9 | 8 | 11 | 8 | 16 | 4 | 8 | G | A | T | I | T | A | L | E | N | T | I | |
| 18 | C | 5 | 16 | 4 | 12 | 7 | 3 | | 2 | | 1 | 14 | A | R | A | M | P | A | F | T | E | R | |
| 8 | I | 6 | | 3 | | 11 | | 8 | 8 | | 9 | 6 | 1 | R | E | T | H | E | P | A | T | I | T |
| 3 | R | 9 | 5 | 2 | 7 | 3 | 12 | 8 | 9 | 13 | | 12 | G | S | H | E | R | E | T | I | K | E | |
| 9 | K | 5 | 2 | 7 | 3 | 1 | 4 | 8 | 15 | 1 | 4 | | A | K | O | M | I | T | E | T | E | T | M |
| 4 | 3 | 5 | 9 | 7 | 8 | 3 | 5 | 12 | 8 | 9 | 7 | | M | E | K | I | P | E | T | T | A | M | |
| 3 | | 16 | 1 | 6 | 4 | | 7 | 15 | 8 | 4 | 1 | | E | I | C | N | E | T | K | A | P | A | K |
| 8 | 4 | 1 | 6 | 6 | 1 | | 16 | 7 | | 7 | 12 | 1 | L | R | I | G | C | S | T | I | L | E | |
| 15 | | 6 | 7 | | | 11 | 1 | 7 | | 4 | 1 | 18 | A | O | P | A | T | E | N | T | A | T | |
| 11 | 1 | 7 | | 17 | 7 | 1 | 12 | | 6 | 8 | 17 | 1 | M | A | Y | E | O | R | A | R | I | | |
| 10 | 13 | 4 | 13 | 3 | 8 | 16 | 4 | 7 | 4 | | 1 | 3 | G | Y | P | I | P | O | L | I | T | I | K |

- Shkenca pa fenë është e çalë, feja pa shkencën është e verbër (Albert Einstein)
- Njeriu ndjehet i frikësuar vetëm nëse nuk është në harmoni me veten (Hermann Hesse)
- Një shoqëri delsh me kohë lind një qeveri ujçerish
- (Bertrand de Jouvenel)
- Librat janë për njerëzit që urojnë të ishin diku tjetër (Mark Twain)
- Gjithkush dëshiron të jetojë në kurriz të shtetit.
- Ata harrojnë se shteti jeton në kurriz të të gjithëve (Frederic Bastiat)

Thënie të mençura

PËRÇJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | R | K | A | M | A | R | S | H | P | R | T | |
| K | A | O | S | I | N | I | K | U | R | A | | |
| S | H | E | N | D | E | T | A | N | E | | | |
| A | T | A | T | E | L | E | F | O | N | A | T | |
| R | T | E | N | I | S | T | E | T | H | A | | |
| K | U | V | E | R | T | A | T | R | I | T | E | |
| N | E | R | V | I | I | S | E | L | | | | |
| A | R | A | S | M | A | T | R | O | N | A | | |
| R | E | V | O | L | T | A | N | E | S | O | N | |
| K | L | R | E | E | D | G | D | C | R | T | | |
| A | L | I | T | A | R | E | M | A | M | I | | |
| T | A | K | T | E | N | I | L | Y | R | A | K | |
| A | R | I | K | T | A | P | I | N | V | A | | |
| B | E | S | N | I | S | I | A | R | R | E | S | T |
| A | D | M | A | T | E | R | I | A | L | | | |
| T | R | I | M | E | R | I | T | E | D | E | | |
| P | A | R | A | K | A | L | I | M | F | A | T | |
| A | L | I | T | E | R | A | C | I | O | N | I | |
| T | I | M | E | H | V | L | I | L | K | | | |
| E | E | A | S | T | O | A | T | I | L | A | | |
| N | N | I | T | K | A | L | L | E | P | I | | |
| T | E | S | A | R | A | J | E | M | I | T | R | O |
| A | E | M | K | A | P | A | K | E | T | | | |
| T | O | T | A | M | A | R | A | A | T | | | |

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

